



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Agroushqim”

i

Institucionit të Arsimit të Lartë

Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Ass. Dr. Rozeta Hasalliu

2. Dr. Anisa Dhroso

Muaji/Viti

Korrik 2021

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Për Programin e studimit Bachelor në “Agroushqim” ofruar nga Universiteti “Fan S. Noli” Korçë

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Agroushqimit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bsc në “Agroushqim”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 420, date 27.06.2012
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	UMASR Nr. 323, datë 05.06.2017
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	PAE 21/PAK 1 v.a 2017-2018 PAE 22/PAK 1 v.a 2018-2019 PAE 23/PAK 1 v.a 2019-2020
18	Numri i studentëve:	v.a 2016-2017 40 Studentë v.a 2017-2018 46 Studentë v.a 2018-2019 15 Studentë
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës

Ky raport u hartua nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga institucioni pranë ASCAL dhe nga takimet me stafin akademik, studentët, dhe përfaqësues të zyrave të ndryshme, me qëllim akreditimin e programit të studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Agroushqim”. Mbi bazën e tyre është bërë plotësimi i kriterëve të standardeve të vlerësimit të jashtëm. Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Agroushqim”, është program studimi ofruar nga Fakulteti Bujqësisë pranë Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë.

Referuar kurrikulës së programit studimit të ciklit bachelor “Agroushqim”, ky program i ofron studentëve njohuritë e duhura në fushën e teknologjisë së përpunimit të ushqimeve, duke i bërë ato të denjë për tregun e Industrisë së përpunimit Agroushqimor, si dhe të kontrollit të cilësisë dhe sigurisë së ushqimeve. Shtojca 2.7, [Struktura e Planit Mësimor].

Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të parë të studimit “Agroushqim”, duke u mbështetur në VKM.41 datë 24.01.2018 i ndryshuar disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e studimeve. Në administrimin e këtij programi ndihmojnë gjithashtu rregullorja e studimeve të Universitetit të Korçës, rregullorja e programit të studimit Agroushqim, kurrikula dhe plani mësimor, ku jepet informacion i qartë për studentët mbi kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Shtojca 1.2, [Rregullorja e UK]. Shtojca 2.5, [Rregullore e Studimit BA AGU]. Shtojca 2.8, [Plani mësimor i Programit të Studimit].

Programi i studimit është organizuar në tre vjet studime, gjashtë semestra me 41 njësi lëndore, të organizuara në 22 module dhe 2 lëndë të praktikës profesionale, të vlerësuara me kredite. Lëndët bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore dhe ato plotësuese janë të ndara në përqindje sipas VKM.41 datë 24.01.2018 i ndryshuar. Një vit akademik përmban gjithsej 60 kredite, të ndara nga 30 kredite për semestër, dhe tre vitet përmbajnë 180 kredite gjithsej. Shtojca 2.7, [Struktura e Planit Mësimor].

Departamenti i Agroushqimit është i pajisur me laboratorë mësimorë dhe kërkimorë shkencorë që përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik. Shtojca 4.7, [Tabrls e të dhënave infrastrukture].

Universiteti “Fan S. Noli” ka politika, për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. Struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, ka të bëjë më gjerë me një njësi të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në përputhje me aktet ligjore. Shtojca 3.7, [Raporti Vjetor i NJSBC Fakulteti i Bujqësisë].

Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

Rektorati i Universitetit "Fan S. Noli", Korçë pas konsultimit me drejtuesit e njësisë bazë "Agroushqim", Fakulteti i Bujqësisë vendosën fillimin e procesit të akreditimit të Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor "Agroushqim" 3 vjeçar pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i cili u përzgjedh për vlerësimin e këtij programi përbëhet nga Prof. Asoc. Dr. Rozeta Hasalliu dhe Dr. Anisa Dhroso, në udhëheqjen e Koordinatorit teknik të ASCAL Z. Muhamed Prezja. Raporti i vlerësimit të jashtëm u hartua nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga institucioni pranë ASCAL dhe nga takimet me stafin akademik, studentët, dhe përfaqësues të zyrave të ndryshme, me qëllim akreditimin e programit të studimit të Ciklit të Parë Bachelor "Agroushqim". Në bazë të Agjendës së vizitës dy ditore (9 – 10 mars 2021) të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm për Vlerësimin dhe Akreditimin e programit të studimit: *Bachelor në "Agroushqim"*, të Universitetit "Fan S. Noli" të Korçës të miratuar nga të gjitha palët e përfshira u realizuan këto veprimtari të planifikuara.

Në ditën e parë të procesit të vlerësimit u realizuan këto takime:

Takimi i parë u realizua midis Grupit të Vlerësimit të Jashtëm (Prof. Asoc. Rozeta Hasalliu ; Dr. A. Dhroso) dhe Koordinatorit Teknik të ASCAL (Muhamed Preza), ku u diskutua për mënyrën se si do të zhvilloheshin takimet e planifikuara. Takimi i dytë u realizua me Dekanin e Fakultetit Prof. Gjergji Mero dhe Përgjegjës të Departamentit Prof. Gjergji Papa. U diskutua në lidhje me detyrën e Dekanit dhe Përgjegjës të Departamentit në mbarëvajtjen e Programit Studimor. Gjithashtu, ata u përgjigjën pyetjeve të përgatitura nga grupi i vlerësimit të jashtëm. Takimi i tretë u realizua me Anëtarët e GVB-së : Prof. As. Dr. Fehmi Xhemo, Prof. As. Dr. Irena Kallco (mungonte), Prof. As. Dr. Ilir Nicko, Dr. Sulltana Ajce, Student Vangjush Cyreku, ku u diskutua në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar. Takimi i katërt u realizua me Stafin akademik të brendshëm dhe të jashtëm për këtë program studimi, ku u diskutua në lidhje me Syllabuset për secilin modul, financimin nga ana e departamentit apo fakultetit për aktivitete që ndihmojnë në kualifikimin e tyre, etj. Takimi i pestë u realizua me Përfaqësues të Zyrave/ Drejtorive (Drejtorinë e Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor dhe Koordinatorin e projekteve Erasmus+) dhe me Përfaqësues të Drejtorisë dhe Qendrës (Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit; Qendra e Karrierës dhe Alumni), ku u diskutua për rolin e secilës zyrë në mbarëvajtjen e Programit të Studimit. Mbyllja e ditës së parë të takimeve u krye me takimin midis Grupit të Vlerësimit të Jashtëm dhe Koordinatorit Teknik të ASCAL. U diskutua në lidhje me takimet e zhvilluara në ditën e parë. Koordinatorin Teknik të ASCAL u kujdes që takimet të kryheshin në oraret e përcaktuara, të ishin prezent pjesëmarrësit e duhur dhe të krijohej atmosferë mirëkuptimi. Gjatë takimeve u kërkua nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dokumentacion shtesë.

Në ditën e dytë të procesit të vlerësimit u realizuan këto takime:

Takimi i parë u realizuar midis Grupit të Vlerësimit të Jashtëm dhe Koordinatorit Teknik të ASCAL. Takimi i dytë u realizua me Studentët e vitit të parë, të dytë dhe të tretë të këtij programi. Gjithashtu, Student të Masterit shkencor. Në këtë takim u diskutua për mënyrën sesi u njohën me këtë program studimi dhe përse e zgjedhën, mënyrën e regjistrimit, mënyrën e zhvillimit të mësimin, mendimin e tyre për pedagogët e lëndëve, mbështetja nga ana e pedagogëve për pjesëmarrjen e tyre në aktivitete të ndryshme, efikasitetin e përdorimit të Bibliotekës dhe për kërkesat e tyre ndaj departamentit. Takimi i tretë u realizua me Punonjësen e sekretarisë për programin e studimit: *Bachelor në "Agroushqim"*, ku u njohëm me detyrat e saj, përshëmbull me mënyrën e regjistrimit të studentëve, zhvillimin e provimeve, me regjistrat e mbajtjes së të dhënave etj. Takimi i katërt

u realizua midis Grupitë Vlerësimit të Jashtëm dhe Koordinatorit Teknik të ASCAL, ku u diskutua mbi ecurinë e procesit të vlerësimit dhe për dokumentacionin shtesë, ku Koordinatori Teknik ndihmoi në pasqyrimin dhe plotësimin e dokumentacionit. Në përfundim të ditës së dytë të takimeve, u krye takimi me Përgjegjësine Departamentit Prof. Gjergji Papa, ku shkëmbyem mendimet mbi mënyrën e mbarëvajtjes së takimeve, sugjerimet apo kërkesat tona.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



LISTA E SHKURTIMEVE

AKU-	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit	MASR	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinise
AL-	Arsimi i Lartë	PA	Personel Akademik
ASCAL-	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë	PS	Program Studimi
BA AGU-	Bachelor Agroushqimor	PS BCH AGU	Program Studimi Bachelor Agroushqimor
DAGU-	Departamenti i Agroushqimit	RVB	Raporti i Vlerësimit te Brendshëm
ECTS-	European Credit Transfer System	UNIKO	Universiteti i Korcës
FB-	Fakulteti i Bujqësisë	VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
GVB-	Grupi i Vlerësimit të Brendshëm		
IAL-	Institucioni i Arsimit të Lartë		

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




Vlerësimi I Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Agroushqim”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>Në bazë të raportit të GVB, programi i studimit Bachelor Agroushqimor, si pjesë e programeve të Universitetit “Fan S. Noli” Korçë, ofron mundësi për arsimim cilësor dhe përgatitje profesionale në edukim. Shtojca 1.3, [Plani Strategjik i zhvillimit UNIKO 2016 – 2020].</p> <p>Kriteri i parë është se Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare. Si një institucion publik i Arsimit të Lartë në Shqipëri, UNIKO synon të formojë specialist të lartë dhe të përgatisë shkenctarë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen e standardeve të demokracisë në vend. Gjithashtu, të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal, si dhe në forcimin e sigurisë publike dhe kombëtare. Programi nuk bie ndesh me interesat kombëtare duke qenë se ai synon kualifikimin e specialistëve në fushën e agronomisë, një sektor me rendësi kombëtare.</p> <p>Shtojca 2.5, [Rregullore e programit të studimit të BA AGU, faqja 3].</p>
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Në përputhje me ligjin për Arsimin e Lartë, Fakulteti i Bujqësisë ka synuar që nëpërmjet programeve që ofron të kontribuojë në rritjen e standardeve të shoqërisë duke përgatitur të rinj profesionistë në degët përkatëse dhe të denjë në jashtë vendit. Mbështetur në Kriterin e dytë PS BCH AGU synon ruajtjen e vlerave akademike e kulturore kombëtarë.</p> <p>Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë ofron kete program studimi, i cili është një vazhdimësi i tradites disa vjecare te saj ne pergatitjen e specialisteve ne fushen e agroushqimit. Shtojca 2.5, [Rregullore e programit të studimit të BA AGU, faqja 3].</p>
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Departamenti i Agroushqimit ka një strategji afatshkurtër dhe një strategji afatgjatë për përmbushjen e synimeve dhe qëllimeve të mishëruara në vizionin dhe misionin e tij. Kjo tregohet në Shtojca 2.3, [Plani strategjik për zhvillimin e njësisë Agroushqim], faqe 6, Misioni i departamentit.</p> <p><i>Misioni i Departamentit të Agro-Ushqimit:</i> <i>Misioni i DAGU është të përgatisë specialistë të Agro-Ushqimit me kualifikim të lartë dhe aftësi konkurruese për nevojat e tregut, të aftë të ballafaqohen me sfidat e zhvillimeve të shpejta, duke gjetur, përpunuar dhe shpërndarë inovacione dhe njëkohësisht nëpërmjet kërkimit shkencor brenda departamentit të jetë konkurrues në treg.</i></p> <p>Rëndësia e këtij programi studimi tregohet edhe tek mendimi i dekanit</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

	(Shtojca 3.1, [Mendimi i Dekanit]): Synimet kryesore të këtij program studimi janë që të përgatisë specialistë të kualifikuar, të aftë të përballen me sfidat e kohës për të drejtuar linja dhe fabrika agropërpunuese, të përgatisë specialistë të aftë për të punuar në pika doganore si inpektore të cilësisë të produkteve ushqimore, si dhe të përgatisë një brez specialistësh me vizion për të ardhmen.		
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Programi i studimit është hartuar në përputhje me njohuritë shkencore, teknologjitë bashkohore për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe kombëtar. Shtojca 1.3, [Plani Strategjik 2016-2017]. Shtojca 2.3, [Plani Strategjik për zhvillimin e Njësisë Agroushqim].		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi L2	
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Hartimi i programit të studimit të ciklit të parë BCH në AGU, është ofrohet në përputhje me strategjinë e zhvillimit të UNIKO dhe në përputhje me parimet e deklaratës së Bolonjës. Në përmbushje të strategjisë së zhvillimit të UNIKO, programi i studimit në “Agroushqim” arrin të përgatisë student për profesione dhe biznese agroushqimore, të fuqizojë pozitën konkurrese të sektorit të agroushqimit në Shqipëri dhe të përmirësojë cilësinë dhe sasinë e produkteve agroushqimore nëpërmjet mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve. Kjo tregohet në dokumentin Shtojca 1.3 [Plani Strategjik UNIKO 2016-2020, faqja 9, Misioni].
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Në bazë të RVB, disa dokumenta strategjikë që lidhen me bujqësinë dhe zhvillimin rural i japin një përparësi formimit profesionale në agroushqim dhe vecanërisht në prodhimin e produktete ushqimore. E orientuar nga këto dokumenta strategjikë, UNIKO i ka dhënë një rëndësi agroushqimit. Statuti i FB dhe rregullorja e Njësisë bazë Agroushqim përcaktojnë drejtimit prioritar akademike dhe tregojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me këto prioritete. (Shtojca 1.1 [Statuti i UK]). Shtojca 2.3, [Rregullorja e Njësisë Bazë Agroushqim].
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Programi i studimit Agroushqim, mbështetur në VKM-në nr. 230, datë 29.51992 “Për hapjen e disa degëve në Universitetin e Korçës”. Kjo tregohet në dokumentin (Shtojca 2.1, [Dokumenti i licensimit të Programit të Studimit BA AGU]). Në dokumentin e paraqitur, tregohet hapja e degës në Fakultetin e Bujqësisë: Inxhinieria agronomike për prodhimin bujqësor me afat studimi 4.5 vjet dhe Kuotat e pranimit të vitit 2012 dhe në bazë të pikës së 4 (VKM 230 – për degët e reja që do të hapen, ngarkohet Komiteti Ekzekutiv i RRehit të Korçës). Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit. Organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit bëhet me qëllim formimin e profesionistëve të përshirë në administrimin, vlerësimin dhe procesin Agroushqimor.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	Emërtimi përputhet me përmbajtjen dhe tërësinë e moduleve që zhvillohen në këtë program, duke i dhënë atij karakterin e një programi studimi që jep njohuritë bazë në fushën e groudshqimit. Ky PS u krijon mundësi studentëve të vazhdojnë studime të thelluara ose të avancuara në disa drejtime të shkencave të ushqimit.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi I.3	
Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit janë të përcaktuar objektivat dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundimin e tij. Programi i studimit ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këtë program, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale në Sektorin e Agroudshqimit, që fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit.</p> <p>Studentët që përfundojnë këtë program studimi specializohen në fushën e agroudshqimit dhe mund të punësohen në të gjitha sektorët e Bujqësisë, Arsimit dhe Shkencave Bujqësore. Ai mund të punësohet si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Specialist në laboratorin ushqimor në DBUMK • Pranë inspektoriatit të kontrollit të Metrologjisë dhe Peshëmarrjes • Në shkollat e mesme profesionale profil bujqësor, si mësues etj. • Si specialist dhe drejtues i linjave dhe fabrikave të Korces dhe më gjerë në Industrinë Agroudshqimore. <p>Dokumenti i dorëzuar është Shtojca 3.8 [Analiza Vjetore të njësisë bazë Agroudshqim].</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Program i studimit është i hershëm dhe detyrimisht nuk disponojnë një studim tregu që i paraprin hapjes së tij. Si shembull, është dorëzuar studimi i degës së Menaxhimit Veterinar, shtojca 3.12 [Studim tregu shembull të dhëna për punësimin e studentëve]. Dokumenti është dorëzuar.</p> <p>Qendra e Karrierës dhe Alumnit ka ndërtuar bazën e të dhënave të studentëve që diplomohen në UNIKO me synimin për të ndjekur punësimin e tyre. Ky dokument është dorëzuar, shtojca 3.12 [Studim tregu shembull të dhëna për punësimin e studentëve].</p> <p>Të dhënat për gjurmimin e studentëve :</p> <p>viti 2018-2019: sudentë 28, vazhdojnë studimet 13, të papunësuar 2, të pidentifikuar 12.</p> <p>viti 2017-2018: sudentë 24, vazhdojnë studimet 7, të punësuar 4 (16.6%), të papunësuar 1, të pidentifikuar 12.</p> <p>viti 2016-2017: sudentë 21, vazhdojnë studimet 4, të punësuar 3 (33.3%), të papunësuar 14, të pidentifikuar 1.</p> <p>Departamenti i agroudshqimit ka parashikur studimin e tregut të punës për të gjitha programet e studimit që disponon duke koordinuar punën me Qendrën e Karrierës dhe Alumnit dhe institucionet e tjera punëdhënëse. Dokumenti i dorëzuar Shtojca 4.3 [Tabela e programeve të studimit që</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>ofron Departamenti Agroushqim], paraqet programin e studimit 2018-2019 dhe 2020-2021, por jo plan konkret.</p> <p>Synimet kryesore të programit të studimit “Bachelor” në “Agroushqim”, që do të merren në këtë kurs studimi janë përgatitja e specialistëve të kualifikuar për të drejtuar fabrika përpunuese, për të punuar në pika doganore, në institucione arsimore të mesme dhe të larta. Dokumenti i dorëzuar, Shtojca 2.5 [Rregullore e Programit të Studimit BA AGU].</p>			
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathësisë e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Në bazë të RVB, i janë refuruar disa studimeve të tregut të punës që paraqesin sektorët më potencial rritjeje dhe nevojat për punësim. Në këtë rast i referohemi informacionit tregtar dhe anketimeve të kryera nga biznese partnere, sipërmarrje ushqimore dhe vetë studentëve të diplomuar. Dokumenti i dorëzuar, Shtojca 3.17. Stafi akademik i njësisë përgjegjëse dhe njësisë kryesore, ofron shërbime profesionale ndaj palëve të treta. Për këtë pikë, nuk ka dokument të dorëzuar. Organizimi i një pjesë të praktikave mësimore pranë sipërmarrjeve ushqimore dhe fesa përfaqësuesve të këtyre bizneseve për të dhënë leksione që i shërbejnë përafrimit dhe përditësimit të syllabuseve.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi I.4

Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Programi i studimit Agroushqim, është hapur mbështetur në VKM-në nr. 230, datë 29.5.1992 “Për hapjen e disa degëve në Universitetin e Korçës”. Kjo tregohet në Shtojca 2.1, [Dokumenti i licensimit të programit të studimit BA AGU].</p> <p>Në fakultetin e Bujqësisë u krijua dega e “Agroushqimit” ku specializohen 30-35 veta në çdo vit akademik. Specializimi fillon nga viti i dytë. Programi i studimit të ciklit të parë në profilin “AGU” realizohet pranë Fakultetit të Bujqësisë dhe Departamenti “AGU” është përgjegjës për zbatimin e këtij programi.</p> <p>Infrastruktura dhe mjediset në dispozicion të Departamentit sigurojnë një zhvillim normal të punës mësimore dhe kërkimore-shkencore. Mjediset për fakultetin/përgjegjës për programin e studimit janë 2766 m² dhe mjediset për stafin 370 m². Programi i studimit ofron organizim bashkëkohor në përputhje me kërkesat e zhvillimit të Rajonit.</p> <p>Njësia bazë përgjegjëse për programin “Agroushqim”, ka një personel akademik me shkallë kualifikimi të lartë: 3 profesorë të asociuar, 3 doktor shkencash, 4 master i shkencave. Të dhënat mbi personelin akademik të Fakultetit të Bujqësisë në UNIKO gjenden në shtojcën 4.8 [Tabela e të dhënave për kualifikim dhe kërkim shkencor]. Personeli akademik i angazhuar në departament janë 10 veta: 3 profesorë të asociuar, 3 doktor shkencash, 4 master i shkencave</p> <p>Të dhënat mbi personelin akademik të fakultetit të Bujqësisë dhe të fakulteteve të tjera që mbulojnë module në programin e Agroushqimit</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>gjenden në shtojcën 4.1 [Lista e personelit akademik të angazhuar në programin e Studimit]. Dokumenti është dorëzuar mbi të dhënat përpersonelin akademik që mbulon departamentin ndër vite (2016 – 2019). Stafi pedagogjik (personel akademik) është 20 veta.</p> <p>Stafi pedagogjik i këtij programi studimi (viti 2018-2019) përbëhet nga 1 pedagogë me titullin Profesorë doktor, 8 pedagogë me titullin Profesor i asociuar dr., 7 pedagogë me titullin doktor dhe 3 me titulli MSc.</p> <p>Bazuar në të dhënat tabelore të stafit të angazhuar në programin e studimit BCH AGU, sipas rezulton se ka një promovim të stafit në titujt akademik të fituar ndër vite.</p> <p>2016-2017 janë gjithsej 18 personel akademik nga të cilët: me titull Prof. Dr 2; Prof. Asc 8; Dr 6; Msc 2.</p> <p>2017-2018 janë gjithsej 18 personel akademik nga të cilët: me titull Prof. Dr 2; Prof. Asc 8; Dr 6; Msc 2.</p> <p>2018-2019 janë gjithsej 32 personel akademik nga të cilët: me titull Prof. Dr 1; Prof Asc 8; Dr 7; Msc 3.</p>			
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasi fikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Në bazë të RVB, Agroushqimi është një fushë e industrisë ushqimore dhe e bujqësisë, dhe si e tillë është plotësisht në përputhje apo pjesë e asaj që ofron njësia kryesore, Fakulteti i Bujqësisë. Kodifikimi i programit të studimit të ciklit Bachelor në AGU, duke u bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015, Neni 86, nuk është kryer.</p>			
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Njësia bazë përgjegjëse për zhvillimin e PS BCH AGU, është departamenti AGU. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore Agroushqimore. Në programin e Studimit, vihet re nje ekulibër midis lëndëve të formimit të përgjithshëm dhe lëndëve me karakter profesional. Shtojca 2.5, [Rregullore e Programit të Studimit BA AGU].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie</p>	<p>Në bazë të RVB, Programi i studimit “Bachelor” në Agroushqim bazohet në Rregulloren e brendshme, Rregulloren e organizimit dhe veprimtarisë mësimore, kërkimore shkencore e Universitetit “Fan S. Noli”; rregullorja e</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423


E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisive e personelit, marrjes së përgjegjësisive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>studimeve e Fakultetit të Bujqësisë. Këto rregullore janë hartuar, miratuar e mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë dhe Statutin e UNIKO. Shtojca 1.1, [Statuti i UK]. Shtojca 2.3 [Rregullore e Njesisë Bazë Agroushqim]. Shtojca 1.2 [Rregullore e UK]. Shtojca 2.2, [Rregullore e Njesisë Kryesore të FB]. Mbikëqyrjen, mbarëvajtjen dhe drejtimin e programit të studimit të ciklit Bachelor në profilin “Agroushim”, e bën përgjegjësi Departamentit të Agroushqimit. Në bazë të dokumentave të dorëzuara vërehet se përgjegjësi i departamentit është përgjegjës për hartimin, propozimin e programit dhe kërkimit shkencor, zhvillon analizën e punës së personelit, të cilat i monitoron nëpërmjet analizës periodike vjetore të veprimtarisë mësimore –kërkimore.</p>			
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Procesi mësimor realizohet me ndihmën e intitucioneve homologe brenda dhe jashtë vendit si dhe nga bizneset e ndryshme që operojnë në fushat e përshtatshme për departamentin për kryerjen e praktikave mësimore dhe profesionale. Në dokumentin Shtojca 2.10 jepen marrëveshjet bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale, me: Kolegjin Universitar “Logos”; Kantinën e pijeve “Korca 2000”; Shoqatën “Ali frut” Dvoran; Kompaninë “Fix Pro” shpk; Kompaninë “Tona Co”; “Agrofrut” Shpk; Autoritetin Kombëtar të Ushqimit Korcë; Bashkinë Pustec; Bashkinë Bilisht; Bashkinë Korcë dhe Këshillin e Qarkut Korcë. Në dokumentin Shtojca 3.20, jepet tabelë përmbledhëse e praktikës profesionale dhe mësimore: Prof. As. Dr. Ilir Nicko (75 orë), Prof. As. Dr. Fehmi Xhemo (50 orë); MSc Kristi Morava (55 orë), MSc Franc Kokojka (15 orë); Prof.As.Dr. Gjergji Papa (10 orë); Msc Lazart Sulaj (20 orë); Dr. Rezana Pengu (50 ore).</p>			
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Në bazë të RVB, këto bashkëpunime kanë ndikuar në nivelin e vlerësimit të studentëve gjatë praktikave profesionale dhe në punësimin e të diplomuarve. Mbështetur në këto marrëveshje njësia bazë zhvillon dhe harton raporte të përfitimeve nga marrëveshjet, gjetjet e të cilave i përdor për përmirësimin e përfitimeve në të ardhmen (Shtojca 3.6). Në dokumentin e dorëzuar, Shtojca 3.6 tregohet Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet në funksion të program të studimit.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Sipas RVB, UNIKO po punon për hartimin dhe zbatimin e një aktmarrëveshje tip për kryerjen e trajnimeve profesionale për studentët e diplomuar. Vlen të përmenden kurset e trajnimeve me specialist të Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë Korcë.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Sipas RVB, UNIKO po punon për hartimin dhe zbatimin e një aktmarrëveshje tip për kryerjen e trajnimeve profesionale për studentët e diplomuar. Vlen të përmenden kurset e trajnimeve me specialist të Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë Korcë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>




II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Nga shqyrtimi i rregullores së studimeve të Universitetit “Fan S. Noli” gjithashtu dhe rregullores së programit të studimit “Agroushqim”, arrijmë në konkluzionin që: Programi i studimit i ciklit bachelor “Agroushqim” në Universitetin “Fan S. Noli” Korcë, është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Shtojca 1.2, [Rregullore e UK]. Shtojca 2.5, [Rregullore e Programit të Studimit BA AGU].
Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.	Referuar kurrikulës së programit studimit të ciklit bachelor “Agroushqim”, ky program i ofron studentëve njohuritë e duhura në fushën e teknologjisë së përpunimit të ushqimeve, duke i bërë ato të denjë për tregun e Industrisë së përpunimit Agroushqimor, si dhe të kontrollit të cilësisë dhe sigurisë së ushqimeve. Shtojca 2.7, [Struktura e Planit Mësimor].
Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	Me anë të njohurive në fushën e teknologjisë ushqimore dhe cilësisë e sigurisë ushqimore anë të njohurive të marra nga përvetësimi i lëndëve të kësaj kurrikule dhe praktikave në sektorë të ndryshëm të Industrisë Agroushqimore, studentët e diplomuar janë të aftë të punojnë në këtë Industri apo të nxiten në sipërmarrje vetjake të sektorit Agroushqimor, mjaft me rëndësi për vendin tonë.
Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Studentët e këtij programi studimi me anë të përvetësimit të njohurive të marra janë të aftë të zgjidhin probleme të paparashikueshme në sektorin e Industrisë Agroushqimore, por gjithashtu të kenë inisiativa të zbatimit të teknologjive të reja inovative. Studentet me ane të këtyre praktikave janë në gjendje të praktikojnë prodhimin e produkteve me cilësi dhe siguri ushqimore.
Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	Programi i studimit përmban të gjitha elementët që përbëjnë strukturën e programit të studimit, bazuar akteve ligjore e nënligjore. Struktura e planit përfshin disiplina të formimit të përgjithshëm, dhe të disiplinave të fushës së studimit. Shtojca 2.7, [Struktura e Planit Mësimor].
Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Rëndësi në strukturimin e planit mësimor është dhënë praktikave profesionale në sektorë të ndryshëm të Industrisë Agroushqimore, ku studentët njohuritë teorike i ballafaqojnë me ato praktike dhe bëhen të aftë për tu punësuar në këto sektorë. Referuar (Shtojcës 3.21, [Raporti i Praktikave Profesionale), praktikat profesionale vlerësohen me notë në bazë të raportit të paraqitur nga studentët. Duke u bazuar në modulet që përbëjnë këtë program studimi dalim në konkluzionin se ky program ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	Shtojca 2.7, [Struktura e Planit Mësimor].			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush kërkesat ligjore për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Në bazë të Ligjit të arsimit të lartë Nr.80/2015” Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në republikën e Shqipërisë” datë 22. 07.2015, neni 25, pika 4, njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, përbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. Në këtë njësi ka 10 anëtarë me kohë të plotë dhe (mbi) 6 me tituj akademike dhe grada shkencore.</p> <p>Fakulteti është i perbere nga keto Departamente: Agrobiznes, Agroushqim, Agronomi, dhe EDE (Ekonomine Didaktike Eksperimentale). Shtojca 3.7, [Raporti Vjetor i NJSBC Fakulteti i Bujqësisë Faqe 13].</p> <p>Vlerësimi bëhet për Departamentin që është njësi baze, sipas ligjit të arsimit. Gjithashtu dhe informacioni që ofrohet është për Njesine Baze që është Departamenti.</p>			
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.	<p>Pas ngritjes së grupit të punës për Vlerësimin e Brendëshëm (Shtojca 3.3, [Vendimi i njësisë bazë për ngritjen e GVB]), njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi ka caktuar një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori është pedagog i Fakultetit dhe keshillohet me studentet për vendimet që merr. Shtojca 2.11, [Vendimi i njësisë bazë për emërimin e koordinatorit].</p>			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	<p>Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike, në përbërjen e saj janë mbi 7 anëtarë me kohë të plotë dhe mbi 3 me tituj akademike dhe grada shkencore sipas Ligjit të arsimit të lartë Nr.80/2015 neni 25, pika 4. Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, përbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik. Në përbërjen e saj gjenden 10 anëtarë PAE (3 Prof. As., 3 Dr., 4 Msc) dhe 6 PAK (2 Prof. Dr., 4 Msc).</p>			
Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.				
Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.				
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Standardi II.3

Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të parë të studimit "Agroushqim", duke u mbështetur në VKM. 41 datë 24.01.2018 i ndryshuar disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e studimeve. Në administrimin e këtij programi ndihmojnë gjithashtu rregullorja e studimeve të Universitetit të Korçës (Shtojca 1.2, [Rregullore e UK]), rregullorja e programit të studimit Agroushqim (Shtojca 2.5, [Rregullore e Programit të Studimit BA AGU]), kurrikula dhe plani mësimor (Shtojca 2.8, [Plani mësimor i programit të studimit Agroushqim]).
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Programi i studimit është organizuar me 41 njësi lëndore, të organizuara në 22 module dhe 2 lëndë të praktikës profesionale. Lëndët bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore dhe ato plotësuese janë të ndara në përqindje sipas VKM. 41 datë 24.01.2018 i ndryshuar. Lëndët bazë 18.3%, ato karakterizuese 55%, lëndët ndërdisiplinore 15.5% ato plotësuese 7.2 % dhe detyrime permbyllyse 4 %.
Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Programi i studimit është organizuar në lëndë e module të vlerësuara me kredite. Një vit akademik përmban gjithsej 60 kredite, të ndara nga 30 kredite për semestër, dhe tre vitet përmbajnë 180 kredite gjithsej. Shtojca 2.7, [Struktura e Planit mësimor].
Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	Planet mësimore të programeve të studimit japin një informacion të detajuar për ngarkesën mësimore, orët në auditor, ku 25 orë në auditor vlerësohet me një kredit. Informacion jepet gjithashtu mbi frekuentimin dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve Për një vit një student shpenzon 60 kredite kështu që ai shpenzon 1500 orë në vit dhe për të gjithë programin që përmban 180 kredite për të tre vitet shpenzon gjithsej 4500 orë. Shtojca 2.15, [Syllabusët e Programit të Studimit BA AGU].
Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Në rregulloren e studimeve të Universitetit të Korçës, rregulloren e programit të studimit Agroushqim, kurrikulën dhe planin mësimor jepet informacion i qartë për studentët mbi kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Përveç notës mesatare studentit i transferohen kreditet e marra nga një program në tjetrin. Gjithashtu për transferimin e studentëve ngrihet komisioni i transferimit të studentëve nga Fakulteti. Shtojca 1.2, [Rregullore e UK]. Shtojca 2.5, [Rregullore e Programit të Studimit BA AGU]. Shtojca 2.8, [Plani mësimor i Programit të Studimit Agroushqim].
Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabusët e	Në syllabusët e detajuara të këtij programi studimi jepet informacion i qartë mbi praktikën, seminarët orët e laboratorit si dhe të gjithë

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

detajuara) për secilën lëndë, për praktikant, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit. Shtojca 2.15, [Syllabusët e Programit të Studimit BA AGU].			
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Në këtë program studimi, parashikohen përmirësime dhe përditësime të vazhdueshme, për lëndë të reja apo tema të reja brënda lëndës, në fillim të çdo viti akademik. Pasi miratohen në Departament dërgohen në Senat për miratim dhe më pas arkivohet dosja e plotë. Kërkesat për ndryshime vijnë nga Anëtarët e Departamentit dhe miratohen në Departament por këto ndryshime nuk duhet të kalojnë 20%. Shtojca 2.12, [Procedura e ndryshimeve në Planin Mësimor].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënimit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Në këtë program studimi, një vit akademik përmban gjithsej 60 kredite, të ndara nga 30 kredite për semestër, dhe tre vitet përmbajnë 180 kredite gjithsej. Kjo është në përputhje me Ligjin e arsimit të lartë nr.80/2015” Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” datë 22. 07. 2015, neni 73, pika 1. Një semestër ka 15 javë mësimore, dhe meqë një semestër ka 30 kredite atëherë studnetët zhvillojnë 2 kredite në javë ose 25 orë që ka një kredit bëjnë gjithse 50 orë në javë e zhvilluar nga studentët.
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.	Në këtë program studimi, emërtimi i tij “Agroushqim”, përmbajtja e veprimtarive si leksione të shoqëruara me praktika laboratorike dhe praktika profesionale, shpërndarja e lëndëve si bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore dhe plotësuese mundësojnë, njohuri, aftësi për punësim të studentëve në njësi të ndryshme prodhimi të Industrisë Agroushqimore, apo të Autoriteteve të Kontrollit të Cilësisë dhe Sigurisë Ushqimore.
Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënimit dhe aftësisimit profesional.	Duke u bazuar në VKM. 41 datë 24.01.2018 i ndryshuar, lëndët/modulet, shpërndarja e tyre në vite e semestra si dhe vlerësimi i tyre në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënimit dhe aftësisimit profesional.
Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit	Organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me profilin e programit të studimit BCH AGU dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare, me qëllim formimin e

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>profesionistëve në procesin Agroushqimor. Programi i studimit është i organizuar me 41 njësi lëndore, të organizuara në 22 module dhe 2 lëndë të praktikës profesionale. Lëndët bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore dhe ato plotësuese janë të ndara në përqindje sipas VKM. 41 datë 24.01.2018 i ndryshuar. Lëndët bazë 18.3%, ato karakterizuese 55%, lëndët ndërdisiplinore 15.5% ato plotësuese 7.2 % dhe detyrime permbylëse 4 %. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module të vlerësuara me kredite. Një vit akademik përmban gjithsej 60 kredite, të ndara nga 30 kredite për semestër, dhe tre vitet përmbajnë 180 kredite gjithsej. Shtojca 2.7, [Struktura e Planit mësimor]. GVJ mendon se lënda Teknologjia e Përpunimit të qumështit dhe të mishit të ndahen, për ti dhënë rëndësinë e duhur këtyre dy disiplinave të rëndësishme për këtë program studimi. Të dy këto module të bëhen me nga 4 kredite dhe të bëhen modulet e tjera si Ekologji dhe Biokimi me gjithashtu me nga 4 kredite, duke mbetur gjithsej 180 kredite si dhe duke u respektuar përqindja e lëndëve bazë dhe atyre karakterizuese.</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Në këtë program studimi shpërndarja e lëndëve si bazë është 18%, ato karakterizuese 54%, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrimet përmbyllëse janë në raport sipas VKM. 41 datë 24.01.2018, duke i ofruar studentëve transferim, mobilitet dhe punësim. Studentët marrin formimin e duhur teorik në auditor si dhe atë praktik në praktikat profesionale në Bizneset e Industrisë Ushqimore të qytetit të Korçës.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Në këtë program studimi, parashikohen përmirësime dhe përditësime të vazhdueshme, për lëndë të reja apo tema të reja brënda lëndës, në fillim të çdo viti akademik. Pasi miratohen në Departament dërgohen në Senat për miratim dhe më pas arkivohet dosja e plotë. Shtojca 2.12, [Procedura e Ndryshimeve në Planin Mësimor]. Në syllabuset e këtij programi studimi paraqitet literaturë e re dhe bashkëkohore, por në disa syllabuse duhen përditësuar duke shtuar literaturë të 5 viteve të fundit. Shtojca 2.15, [Syllabuset e Programit të Studimit BA AGU].</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Përmbajtja e programeve të studimit me të gjitha lëndët bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore dhe ato plotësuese garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë të fushës së përpunimit të ushqimeve dhe kontrollit të tyre. Studentët me njohuritë e marra gjatë ndjekjes së këtij programi studimi janë të aftë ti aplikojnë ato pas diplomimit në Bizneset e Industrisë Ushqimore ose në Autoritetin Kombëtar të Ushqimit. Shtojca 2.7, [Struktura e Planit Mësimor].</p>
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përmbajtja e programeve të studimit dhe praktikat profesionale pranë Njësisë të prodhimit të Industrisë Agroushqimore mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. Pavaresisht faktit që studentet kane njohuritë dhe kompetencat e duhura për tu punësuar që pas mbarimit të studimeve Bachelor, ato kane gjithashtu njohuritë e duhura për të vazhduar studimet në nivelin</p>

	master. Shtojca 2.7, [Struktura e Planit Mësimor]. Shtojca 3.21, [Raporti i Praktikave Profesionale].			
Per ta Kriteri 9. Për përmirësimin e përbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Zhvillimi i praktikave profesionale dhe përfshirja e pedagogëve dhe studentëve në projekte në të cilat përfshihen bashkëpunëtorë dhe partner nga tregu i punës kanë brë një përmirësim të vazhdueshën të këtij programi studimi në vite si dhe përshtatje me tregun e punës. Shtojca 3.21, [Raporti i Praktikave Profesionale]. Shtojca 4.12, [Lista e Pjesemarrjes se Stafit Akademik].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes së	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	<p>Personeli akademik që angazhohet në realizimin e këtij programi studimi është i përbërë nga 3 Prof. Ass. Dr., nga 3 Dr. dhe 4 MSc. (Shtojca 4.8) duke përmbushur kërkesat ligjore në fuqi, sipas Ligjit të arsimit të lartë Nr.80/2015 neni 25, pika 4.</p> <p>Të dhënat për personelin akademik që mbulon Programin e Studimit Bachelor në Agroushqim:</p> <p>Viti 2017-2018: 21 PAE (2 Prof. Dr., 8 Prof. Asoc. Dr., 7 Dr., 1 Doc, 3 MSc.) dhe 1 PAK (1 MSc.)</p> <p>Viti 2018-2019: 22 PAE (1 Prof. Dr., 8 Prof. Asoc. Dr., 7 Dr., 1 Doc, 5 MSc.) dhe 1 PAK (1 MSc.)</p> <p>Viti 2019-2020: 23 PAE (1 Prof. Dr., 8 Prof. Asoc. Dr., 7 Dr., 1 Doc, 6 MSc.) dhe 1 PAK (1 MSc.)</p> <p>[Të dhëna për personelin akademik që mbulon departamentin Agroushqim].</p> <p>Fakulteti i Bujqësisë në të cilin bën pjesë Departamenti i Agroushqimit ka 77.27% personel akademik me kohë të plotë dhe 22.73% personeli akademik me kohë të pjesshme, 86.36% është staf akademik i kualifikuar dhe 13.64% staf akademik i pakualifikuar.</p>
Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	<p>Personeli akademik që angazhohen në realizimin e këtij programi studimi kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit. Personeli akademik është i kualifikuar për të mbuluar si lëndët bazë, ato karakterizuese dhe plotësuese. Shtojca 4.8, [Tabela e të dhënave për kualifikimin dhe kërkimin shkencor].</p>
Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon	<p>Nga studimi i CV akademike rezultojnë që stafi akademik i cili mbulon lëndët e këtij programi studimi ka kualifikimin e duhur të fushës akademike por dhe të asaj kërkimore shkencore, e cila tregohet dhe me</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.	publikimet e bëra nëpërputhje me programin e studimit dhe specifikën e moduleve të këtij program. Shtojca 2.9, [Jetëshkrimet e Stafit të përfshirë në Programin e Studimit].			
Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Universiteti "FAN S. Noli" ka nënshkruar shumë marrëveshje me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani në fushën e Industrisë Agroushqimore, bashkive të qarkut Korçë, AKU Korçë etj. për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. Shtojca 2.10, [Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave].			
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Në këtë program studimi janë angazhuar personel ndihmës mësimor shkencor, i arsimuar në fushën përkatëse, i përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore. Shtojca 2.3, [Plani Strategjik për zhvillimin e njësisë agroushqimore] neni 17]. Shtojca 2.14, [Jetëshkrimi II Stafit Ndihmës Akademik].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>Statuti i Universitetit “Fan S. Noli” dhe veprimtarisë mësimore dhe kërkimore e UNIKO të hartuara nga Senati Akademik bëjnë të mundur rregullimin e kuadrit të përgjithshëm institucional për mësimdhënien dhe mësimnxënien, si dhe realizon zhvillimin dhe shfrytëzimin e metodave innovative të mësimdhënies. “Shtojca 1.1 [Kreu VI – Programet e studimit dhe organizimi i tyre, Neni 46 – 63 dhe Organizimi i Programeve të Studimit]. Shtojca 1.2 [Kreu VI – Programet e studimit dhe organizimi i tyre, Neni 48 – 95]. Shtojca 3.16 [Model mësimi online], tregohet “Plani i veprimit për zbatimin e projektit “Instalimi i platformës OFFICE 365 FOR EDUCATION” dhe “Zgjerimi (Upgrade) i shërbimit të postës elektronike”, për stafin akademik dhe studentët (Dt. 30.06.20).</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Monitorimi i aftësive mësimdhënëse të stafit akademik bëhet nëpërmjet strukturave të përhershme dhe kontroleve periodike. Departamenti është struktura bazë që monitoron dhe vlerëson. Mbledhjet me personelin akademik kryhen 1 herë në muaj, ku diskutohen probleme të ndryshme në lidhje me mësimdhënien dhe në fund të vitit del Analiza Vjetore e Njësisë Bazë Agroushqim.</p> <p>Në fund të cdo semestri zhvillohet një pyetësor për studentët. Shtojca 1.1, [Statuti i UK]. Shtojca 3.8, [Analiza Vjetore e Njësisë Bazë Agroushqim]. Shtojca 3.13, [Model Pyetësor Studentor].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Studentëve u është garantuar e drejta e pjesëmarrjes në të gjitha hallkat e hartimit të kurrikulave, në vlerësimin e brendshëm të institucionit, si dhe përfaqësimin e tyre në Senatin Akademik. Shtojca 1.11, [Rregullorja e Senatit Akademik]. Kjo tregohet tek Neni 3, Përbërja e Senatit Akademik:</p> <p><i>Në senatin Akademik bëjnë pjesë dhe student në masën dhjetë për qind të numrit të anëtarëve të senatit. Dy përfaqësues të studentëve të zgjedhur sipas përcaktimeve të nenit 37, pika 4, të ligjit nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë.</i></p> <p>Studentët janë shumë aktivë gjatë procesit të organizimit të pyetësorëve dhe të gjitha sugjerim ankesa e tyre merren në konsideratë në takimin e rradhës të analizës mësimore. Shtojca 3.8, [Analiza vjetore të njësisë bazë të agroushqim].</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë janë përgjegjësi i departamentit, Drejtoria e Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor, rregullorja e studimeve universitare dhe rregullorja e programit të studimit, rektorati përgjegjës për mësimdhënien.</p> <p>Shtojca 1.5, [Rregullore e Drejtorisë së Kurrikulave, neni 4, Misionin</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>dhe Veprimtaria e DKSCK-së]. Shtojca 1.2 [Rregullorja e UK, neni 124] tregohet Rregulloret e Fakulteteve: "Rregullomi i mëtejshëm i të drejtave dhe detyrimeve të organeve dhe autoriteteve drejtuese të fakulteteve në përputhje me Statutin e UK dhe këtë rregulore, do të bëhet nga rregulloret e fakulteteve dhe miratohen në Senatin Akademik". Në dokumenti Shtojca 2.3 [Rregullorja e Njësisë Bazë Agroushqim, neni 11 "Drejtuesi i Departamentit"], paraqet në pikat b,c,f funksionet e Drejtuesit të Departamentit: b. Mbikqyr veprimtaritë shkencore në departament, në përputhje me planifikimin vjetor, mban dokumentacionin e veprimtarisë mësimore-shkencore të personelit akademik të departamentit, pas raportimeve në analizën vjetore të tij... Fakulteti i Bujqësisë dhe Departamenti Agroushqim për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit në analizën vjetore të departamentit, fakultetit, universitetit dhe në faqen e universitetit.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Nga rezultatet e pyetësorëve DAGU identifikon pedagogët që performojnë marrëdhëniet më të mira me studentët dhe që përdorin metoda inovative të mësimdhënies. Performanca e personelit akademik diskutohet në mbledhjet e departamentit dhe pasqyrohen në Analizën Vjetore të Departamentit dhe të Universitetit. Shtojca 3.14, [Model Pyetësor i Stafit Akademik]. Në dokumentin e dorëzuar Shtojca 3.18, paraqitet shembulli i orëve të hapura, Njoftim mbi temën "Aplikimi i Bioteknologjisë në Bujqësi" nga MSc. Frans Kokojka dhe "Mbarështimi i gjethëve" Prof. As. Dr. Fehmi Xhemo. Zhvillimi i orëve të hapura tregon promovimin e praktikave të mira, nxitjen dhe inkurajimin e personelit akademik.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.2 Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Në dokumentin e dorëzuar Shtojca 2.15, jepen Syllabusët e Programit të Studimit. Për secilën nga lëndët që ofrohet ekziston një syllabus që pasqyron mësimdhënien dhe mësimnxënien: leksione, seminarë, praktika mësimore, laboratorë, detyra, projekte, literaruta bazë dhe ajo e rekomanduar. Programet e studimit hartohen nga cdo pedagog dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit. Cdo pedagogu i jepet e drejta të bëjnë përmirësime të vazhdueshme në programet mësimore dhe ti pasurojë ato. Nga shqyrtimi i syllabuseve u vu re mospërputhje midis aktivitetit mësimor dhe temave të vendosura. Grupi i vlerësimit të jashtëm mendon se duhet të rregullohen në lidhje me ligjin e arsimit të lartë: MSC Radiola Guliqani FIZIKE, 37 orë, 22 orë leksion, 15 orë seminar. Në syllabus janë vendosur tema laboratorësh. Prof. Dr. Lorenc Ekonomi Informatikë: 22 orë leksion, 30 orë laborator/seminar. Nuk paraqiten temat e laboratoreve. Prof. As. Dr. Fehmi Xhemo Prodhimi Shtazor: 30 leksion, 6 seminar</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>dhe 24 laborator. Nuk paraqiten temat e laboratoreve.</p> <p>Prof. Pirro Icka Fiziologjia e Bimeve: 38 leksion, 7 seminar, 15 laborator. Nuk paraqiten temat e laboratoreve.</p> <p>Prof. Robert Damo Plehrat dhe pleherimi: 30 leksione, 15 praktika laboratorike, 15 seminare. Nuk paraqiten temat e laboratoreve.</p> <p>Prof. As. Dr. Fehmi Xhemo Teknologjia e Qumështit dhe e mishit: 37.5 leksion, 5 seminar dhe 17.5 laborator. Nuk paraqiten temat e laboratoreve.</p> <p>Prof. As. Dr. Nikollaq Roshanji Bazat e pemëtarisë: Syllabusi nuk është i njëjtë me të tjerët (në formë tabelare). GVJ nuk është e qartë nëse praktikant janë laboratore. Ato janë 8 orë apo 10 orë(+).</p> <p>Prof. As. Dr. Nevruz Zeka Bazat e perimtarisë: 45 leksion, 5 seminar, 10 laborator. Nuk paraqiten temat e laboratoreve.</p> <p>Dr. Sulltana Ajce Procese dhe aparate të teknologjisë ushqimore: 30 leksione, 5 seminare, 25 laborator. Nuk paraqiten temat e laboratoreve.</p> <p>Prof. As. Dr. Irena Kallco, Cilësia mikrobiologjike e produkteve ushqimore, 26 leksion, 26 seminar. Në syllabus ka tema laboratorit.</p> <p>Gjithashtu, mendojmë se në literaturën e rekomanduar duhet të përfshihen dhe literatura e viteve të fundit.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Personeli akademik ofron forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti. Nga programi i studimit, vërejmë se pjesa më e madhe e moduleve i përkasin shkencave natyrore dhe agroushqimore. Në vitin e dytë dhe të tretë studentët kanë mundësi që nëpërmjet praktikave mësimore dhe profesionale të përfitojnë njohuri në fushën e teknologjisë së përpunimit të ushqimeve, duke i bërë ato të denjë për tregun e Industrisë së përpunimit Agroushqimor, si dhe të kontrollit të cilësisë dhe sigurisë së ushqimeve. Shtojca 2.5, [Rregullore e Programit të Studimit BA AGU]. Shtojca 3.8, Analiza Vjetore e Njësisë Bazë Agroushqim].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>FBU mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit. Pjesëmarrja e personelit akademik në Projekte si Tempus dhe Erasmus+, ndihmon në përfitim e metodave të reja dhe teknika inovative, duke u vënë në funksion të mësimdhënies. Shtojca 3.8, Analiza Vjetore e Njësisë Bazë Agroushqim]. Shtojca 3.32, [Analizë Vjetore UNIKO].</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit. Rekrutimi i personelit synon përzgjedhjen e personelit akademik të kualifikuar dhe kompetent në fushën e tij. UNIKO mbështet me trajnime, mësim të hapura dhe praktika, kualifikimin e mëtejshëm të stafit pedagogjik dhe nxit shfrytëzimin e metodave inovative në përputhje me nevojat specifike të punëdhënësve në sektorin industrial ushqimor. Shtojca 3.8, Analiza Vjetore e Njësisë Bazë Agroushqim]. Shtojca 3.9, [Praktikat e miratimit të kriterëve të pranimit]. Shtojca 3.32, [Analizë Vjetore UNIKO].</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik</p>	<p>Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson metodat e mësimdhënies</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. Përgatitja e detyrave dhe projekteve nga studentët, monitorohet nga pedagogët duke rritur bashkëpunimin ndërmjet tyre. Një nga format e përmirësimit të metodave të mësimdhënies dhe të elementëve të procesit mësimor, është anketimi. Studentët përfshihen në këtë proces duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre, nëpërmjet plotësimit të pyetësorëve, në fund të çdo semestri për modulet që mbyllin. Shtojca 3.8, Analiza Vjetore e Njesisë Bazë Agroushqim]. Shtojca 3.13, [Model Pyetësor Studentor]. Shtojca 3.32, [Analizë Vjetore UNIKO].</p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p>	<p>Bazuar në kualifikimet dhe në përgjigjet e anketimeve dhe pyetësorëve, personeli akademik reflekton dhe përdor metodat e reja në leksione e seminare. Shtojca 3.8, Analiza Vjetore e Njesisë Bazë Agroushqim].</p>			
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtime të marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Mbështetur në metodat interaktive të mësimdhënies, rritet aktivizimi i studentëve në procesin mësimor në mënyrë të pavarur ose në grup, duke inkurajuar sensin e autonomisë. Grupi i vlerësimit të jashtëm, në bazë të takimit me studentët mendon se nën mbështetjen e pedagogut, studentët mund të bëhen pjesë të workshopeve, kërkimeve shkencore që nxitin aftësinë e kërkuese- shkencore. Shtojca 3.8, Analiza Vjetore e Njesisë Bazë Agroushqim]. Shtojca 3.32, [Analizë Vjetore UNIKO].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Niveli i përmbushjes</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi III.3 Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Në bazë të vrojtimit nga GVJ të ambienteve ku zhvillohen aktivitetet mësimore dhe laboratorike, disponohen hapësira të mjaftueshme dhe cilësore për zhvillimin e programit të studimit. Gjithashtu, mirëmbahen nga ana teknike dhe sanitare prej personelit ndihmës akademik dhe sanitar. Shtojca 4.7, [Tabelë e të dhënave infrastrukturore në funksion të PS].</p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Mjediset për zhvillimin e procesit mësimor janë sallat e leksioneve, seminareve dhe seanceve laboratorike. Sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisur me tavolina dhe karrige në përputhje me numrin e studenteve dhe janë instaluar aparatet e retroprojektimit. Numri i studentëve në grupin mësimor është në përputhje me VKM 41 përkatësisht deri në 100 studentë për zhvillimin e leksioneve dhe 25 student për çdo grup seminaresh. Gjithashtu laboratorët janë pajisur me pajisje, sipas specifikës së secilit laborator. Përmendim laboratorin biokimik për të cilin janë bërë përpjekje për ta akredituar. Shtojca 3.23, [Praktika e Akreditimit të Laboratorit Agroushqim].</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë</p>	<p>Në bazë të vrojtimit nga GVJ, Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.	konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor. Auditorët janë të pajisur me mjetet e nevojshme për realizimin e procesit mësimor. Kjo paraqitet në dokumentin Shtojca 4.7, Tabela e të dhënave strukturore]. Një infrastrukturë e konsoliduar IT është vendosur në dispozicion të pedagogëve dhe studentëve. Përmendim sistemin elektronik të vlerësimit gjithëvjetor dhe përfundimtar të studentëve. Kjo tregohet në dokumentin e dorëzuar, Shtojca 5.4 [Link].
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.	Literatura bazë përfshin materiale të botuara apo dispenca të përgatitura nga pedagogët, për të gjitha modulet e programit mësimor. Literatura bazë gjendet pranë Librit universitar, Bibliotekës së fakultetit dhe atë universitare. Biblioteka e universitetit është e pasur me 30000 libra të fushave të ndryshme, të cilët janë shpërndarë në 5 mjedise. Kjo tregohet në Shtojcën 4.7, [Tabela e të dhënave strukturore]. Tekstet bazë janë miratuar në njësinë bazë, Shtojca 1.12 [Udhëzim për miratimin e teksteve mësimore]. Gjithashtu, pedagogët paraqesin leksionet me anë të Power Pointit. Literatura e rekomanduar në syllabuse është e pasur, por duhet të përfshihen më shumë edhe tekste të viteve të fundit. Në bazë të këtyre zhvillimeve, personeli akademik duhet të mbështetet për Sigurimin e Fondit të Literaturës Bazë të lëndëve dhe moduleve mësimore, me qëllim që të jetë e zbatueshme dhe të shfrytëzohet nga studentët e këtij programi.
Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	Nga vrojtimet e GVJ, biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor. Ashtu sic është cituar më lart, Biblioteka e universitetit është e pasur me 30000 libra, me mbi 12000 tituj të fushave të ndryshme. Gjithashtu, personeli akademik dhe studentët kanë mundësi hyrjeje në Bibliotekën Dixhitale ProQuest, ku mund të gjenden literaturë bashkëkohore. Në bazë të këtyre zhvillimeve, Pika e dobët “Mungesë e Bibliotekës Dixhitale” e vendosur në Planin Strategjik për Zhvillimin e Njësisë Agroushqimore, duhet të rishikohet.
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Në dokumentin Shtojca 5.3, paraqitet se në dispozicion të personelit akademik dhe studentëve të UNIKO është një librari elektronike e Universitetit (EBSCO, U-Library) e vendosur në një sallë me infrastrukturë moderne, që mundëson hyrjen online të teksteve dhe revistave shkencore mbi agroushqimin dhe për fushat e tjera.
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Nga vrojtimet e GVJ, Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike është e kompletuar me një numër pajisjesh, të cilat shfrytëzohen nga studentët për të kryer analiza fiziko-kimike, mikrobiologjike dhe biokimike. Shtojca 4.7, [Tabela e të dhënave strukturore]. Shtojca 3.23 [Praktika e akreditimit të laboratorit të Agroushqimit], paraqet se laboratorit i agroushqimit funksionon edhe për analiza më të thelluara.
Kriteri 8. Në funksion të	

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) Microsoft Office 365, Shtojca 5.5 [Link].			
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar. Kjo tregohet në dokumentin Shtojca 5.4 [Link] dhe Shtoca 3.22, [Manuali ESSE].			
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Në përfundim të programit të studimit Agroushqim, studentët kanë mundësi të përfundojnë studimet e tyre me provim formimi ose teza shkencore. Në dokumentin, Shtojca 4.13, paraqiten temat e diplomave të aprovuara në vitin 2018. Personeli akademik mbështet studentët gjatë gjithë periudhës së diplomimit, deri në shkrimin e tezës. Shtojca 4.13, [Tema diplomash të realizuara nga studentët].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	
Standardi III.4				
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	<p>Këtë rol në Universitetin e Korçës e kryejnë disa struktura ose zyra: Sektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë (SKSC), ka mbështetjen e Dekanit dhe Përgjegjësit të Departamentit për hartimin, organizimin dhe zbatimin e programit të studimit; mbikëqyr, promovon dhe orienton përmirësimin dhe ndryshimin e vazhdueshëm të kurrikulës; ndjek dhe kontrollon ecurinë e procesit mësimor; ndjek sigurimin dhe kontrollin e cilësisë.</p> <p>Brenda Sektorit të kurrivulave dhe Sigurimit të cilësisë funksionin Njësia e Sigurimit të brendshëm të Cilësisë, ku fokusi i veprimtarisë së kësaj njësie është: Evidentimi dhe ndjekja e problemeve të lidhura me cilësinë e mësimdhënies; Sigurimi i bazës së të dhënave për cilësinë e mësimdhënies; Vlerësimi periodik i rezultateve të veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore; Vlerësimi i ecurisë së studentëve; Organizimi dhe ndjekja e zhvillimit të pyetësorit Studentor; Orientimi dhe udhëheqja metodike për vlerësimin e brendshëm në departament dhe Vlerësimi i performancës akademike.</p> <p>Spektori i Projekteve, Kërkimit Shkencor dhe dixhitalizimit (SPKSHD), harton dhe administron zhvillimin e projekteve, kërkimin shkencor, bibliotekën shkencore dhe dixhitalizimin. Qendra e Karrierës dhe Alumni (QKA), ku misioni i saj është të ofrojë shërbimet më të mira për studentët e ardhshëm, studentët aktual, të diplomuarit, stafin dhe grupet e tjera të interes, në mënyrë që të përmirësohet cilësia e edukimit dhe t'i ndihmojë ata të zhvillojnë potencialin e plotë, për të patur një ndikim domethënës në tregun e punës dhe shoqëri. Shtojca 1.5, [Rregullore e Drejtorisë së Kurrikulave]. Shtojca 1.5.1, [Plani Vjetor Drejtoria e Kurrikulave 2019-2020].</p>			
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes	Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, cilësia e mësimdhënies promovohet dhe monitorohet nga Njësia e Sigurimit të Cilësisë. Çdo vit			

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	bëhet një vlerësim i brendshëm i programit të studimit, ku hartohet një raport që diskutohet me të gjithë anëtarët e departamentit dhe lihen detyra. Shtojca 1.2, [Rregullorja e UK]. Shtojca 1.5, [Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulave], Kreu V, Neni 24. Shtojca 2.3, [Rregullorja e njësive bazë Agroushqim]. Shtojca 2.5, [Rregullorja e Programit të Studimit BA AGU].			
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	GVJ nga takimet dhe shqyrimi i dokumentave konstaton se Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. Metoda e-learning është një metodë inovative në të cilën forma e të mësuarit dhe mësimdhënies zhvillohen nërmjet pajisjeve elektronike. Metodatat e mësimit elektronik ndihmojnë stafet akademike të krijojnë forma më të qëndrueshme dhe të standardizuara. Shpesh leksionet e shtypura janë shoqëruar ose zëvendësuar me versione elektronike si: dokumente, prezantime powerpoint, etj. Në procesin e mësimdhënies janë përdorur teknikat audiovizive, me auditorë dhe laboratorë të pajisur me kompjutera, retroprojektorë, etj.			
Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Personeli akademik dhe ndihmës akademik bëjnë përpjekje të vazhdueshme për kualifikim, në procesin e mësimdhënies edhe të kërkimit shkencor. Përmendim Shkollat pasuniversitare, shkollat doktorale, marrja e titujve dhe gradave. Shtojca 2.4, [Planin Strategjik për Zhvillimin e Njësive Agroushqimore].			
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Shtojca 3.8, paraqet Analizën vjetore të Njësive Bazë Agroushqim, mbi analizën mësimore dhe shkencore. Trajnime afatshkurtra janë realizuar për personelin akademik dhe studentor. Mund të përmendim: 24-27 Janar 2019. Pjesëmarrje në projektin HarISA në Zagreb. 9-11 Qershor 2019. Pjesëmarrje në projektin HasISA në Podgoricë. 27-28 Tetor 2019. Pjesëmarrje në projektin HarISA në Beograd. 26-28 Prill 2020. Pjesëmarrje në projektin HasISA online meeting. Megjithatë, mundësia e bashkëpunimit midis institucioneve brenda vendit dhe jashtë tij duhet të rritet, që të shërbejë për përmirësimin e veprimtarisë së Departamentit.			
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve, të cilët kanë detyra të mirëpërcaktuara në përshkrimin e punës. Përgjegjësi i departamentit, Dekani dhe Rektori bëjnë kontrollë nga regjistri i pedagogut deri tek anketat me studentët. Regjistri i pedagogut është dokument i rëndësishëm, i cili duhet të unifikohet. Ajo përmban Emërtimin e lëndës, Programin e Studimit, Grupin, Kursin, Vitin akademik, Tabelën me emrin e mbiemrin e studentit, Datat e zhvillimit të leksionit, seminarit apo laboratoreve dhe Vlerësimin. Shtojca 3.24, [Modeli Regjistër Pedagogu]. Shtojca 3.13, [Modeli pyetësor studentor].			
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.				
Shkalla e përmbushjes së	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

standardit				X
------------	--	--	--	---

Standardi III.5				
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Shtojca 1.2 [Rregullorja e studimeve universitare] dhe Shtojca 2.5 [Rregullorja e Programit të Studimit], paraqesin kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit bëhen publike dhe njihen nga studentët. Në përfundim të procesit mësimor pedagogët komunikojnë rezultatin e vlerësimit të vazhdueshëm dhe të drejtën për të hyrë në provimin e modulit. Shtojca 3.24, [Model Regjistër Pedagogu].			
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në fillim të çdo lëndë studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuse nga titullari i lëndës. Kjo paraqitet në Shtojcën 3.25, [Model Syllabusi]. Shtojca 2.15, [Syllabuset e Programit të Studimit BA AGU].			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. Kontrolli i dijeve për çdo modul bëhet nëpërmjet formave të ndryshme si vlerësimit i detyrave të kursit, kolegiumeve, pjesmarrjes dhe aktivizimit në seminar dhe laborator. Ky vlerësim i vazhduar gjatë vitit plotësohet me vlerësimin në provimin përfundimtar. Mënyra e vlerësimit dhe ndarjes së pikëve për vlerësimet e sipër përmendura janë të shprehura në në syllabusin e çdo moduli. Në vlerësimin e vazhduar deri në 30% të totalit të pikëve dhe atë përfundimtar. Provimi përfundimtar zë deri në 70% të totalit të pikëve dhe realizohet me shkrim, me gojë ose i kombinuar. Kjo tregohet në Shtojcën 3.25, [Model Syllabusi].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik. Kjo përbën vlerësimin e vazhduar që është diskutuar në standardin III.5. Vlerësimi i vazhduar përbën 30% përqind të rezultatit përfundimtar. Kjo ndarje respektohet dhe paraqitet në syllabuset e cdo lëndë.
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim	Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit,

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>ESSE3, mbi bazën e një marrëveshje me RASH, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën jo vetëm me studentë dhe institucionin, por edhe për palë të treta. Hyrjet në sistem janë vetëm në periudhën e sezoneve. Këto tregohen në dokumentat e dorëzuara Shtojca 1.6 [Rregullore e ESSE3], Shtojca 1.6.1 [Marrëveshje RASH për ESSE3] dhe Shtojca 5.4.</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Testimi dhe vlerësimi përfundimtar i njohurive të fituara gjatë procesit mësimor realizohet nga komisioni me të paktën dy pedagogë i caktuar nga Përgjegjës i departamentit për mësimin, ku njëri prej anëtarëve është edhe titullar i lëndës (Shtojca 3.26). Kjo në bazë të rregullores së njësisë bazë, dokumenti i dorëzuar, Shtojca 2.5 [Rregullore e Programit të Studimit BA AGU. Shtojca 1.2, [Rregullorja e UK, Neni 93, Organizimi i provimeve].</p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Në bazë të RVB, provimet me shkrim zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim. Studentët përdorin fletore të përshtatshme me logon e universitetit dhe hapësirën përkatëse për kodifikim. Kjo tregohet në Shtojcën 3.27, [Model Provimi me Sekretim]. Institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi. Sekretaria me rekomandim të përgjegjësit të departamentit kryen kodifikimin e fletoreve. Pedagogu i korrigjon provimet dhe sekretaria konverton kodin me emrin e studentit.</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënësit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Sipas RVB, në procesin e vlerësimit të njohurive, jo vetëm që synohet të nxirren në pah aftësitë dhe cilësitë më të mira të studentëve, duke shmangur çfarëdo tendence për keqvlërësim, por merret parasysh çdo anketim, ankimim apo dyshim në vlerësimin e studentëve. Kjo mundëson marrjen e feedbackut të nevojshëm për përmirësimin jo vetëm të mësimdhënies, por edhe të sistemit të vlerësimit. Në shtojcën 1.2, [Rregullorja e Universitetit të Korçës], Neni 103, Studenti mbetet dhe ankimimi për provim, Pika 1, thuhet se: <i>Ankesa behet me shkrim brenda ditës së marrjes së rezultatit për provimin me gojë dhe jo më vonë se 8 ditë për provimin me shkrim, nga data e dhënies së tij dhe i drejtohet dekanit të fakultetit.</i></p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik. Shtojca 1.2, [Rregullorja e UK], Kriteri VII, Procedurat e Vlerësimit të studentëve, neni 96-98.</p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Rezultatet e provimeve hidhen në sistem brenda dy ditëve kur provimi është me gojë dhe brenda gjashtë ditëve kur provimi është me shkrim. Vlerësimi i provimeve bëhet me pikë të cilat konvertohen në notë, sipas sistemit shqiptar të vlerësimit me dhjetë nota, nga 1-shi tek 10-ta, ku 10-ta është vlerësimi maksimal. Shtojca 1.2, [Rregullorja e UK], Kriteri VII, Procedurat e Vlerësimit të studentëve, neni 104-105. Shtojca 3.26, [Model Procesverbal provimesh].</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje</p>	<p>Në bazë të takimeve rezultoi se institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit, në përputhje me rregullore. Shtojca 1.2, [Rregullorja e UK].</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Shtojca 2.3, [Rregullorja e njësisë bazë Agroushqim]. Shtojca 2.5, [Rregullorja e Programit të Studimit BA AGU].			
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet. Shtojca 1.2, [Rregullorja e UK]. Shtojca 2.3, [Rregullorja e njësisë bazë Agroushqim]. Shtojca 2.5, [Rregullorja e Programit të Studimit BA AGU].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7	
Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	<p>Programi i studimit BCH AGU zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve, gjatë tre viteve të studimit. Në vitin e parë studenti merr njohuri bazë në shkencat matematike, biologji, kimi (32 kredite) dhe disiplinat formuese anglisht, informatike etj me 9 kredite. Në vitin e dytë dhe të tretë, zhvillohen njohuri në lidhje me disiplinat karakterizuese (97 kredite), disiplinat integruese (24 kredite) dhe disiplinat me zgjedhje të studentit (12 kredite) të programit të studimit. Në përfundim të programit të studimit, studentët e finalizojnë me provim ose tezë (6 kredite). Gjithsej 180 kredite. Lënda Kimi Analitike në bazë të rëndësisë së saj të, sugjerojmë të kthehet nga lëndë me zgjedhje në lëndë bazë, duke ndërhyrë tek kreditet lëndëve formuese (Gjuhe e huaj nga 5 në 4 kredite dhe Informatika nga 4 në 3 kredite) apo organizimin e lëndëve të tjera duke i bërë nga katër kredite (Ekologjia nga 6 në 5 kredite dhe Biologjia nga 5 në 4 kredite).</p> <p>Gjithashtu, ndarjen e Teknologjisë së përpunimit të qumështit nga Teknologjia e përpunimit të mishit, për ti dhënë rëndësinë e duhur këtyre dy disiplinave të rëndësishme për këtë program studimi. Të dy këto module të bëhen me nga 4 kredite dhe të bëhen modulet e tjera si Ekologji dhe Biokimi me gjithashtu me nga 4 kredite, duke mbetur gjithsej 180 kredite si dhe duke u respektuar përqindja e lëndëve bazë dhe atyre karakterizuese.</p> <p>Kjo pasqyrohet në Shtojcën 2.7, [Struktura e planit mësimor] dhe Shtojca 2.8, [Plani mësimor i programit të studimit BCH agroushqim].</p>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale,	Në vitin e parë, Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e komunikimit dhe teknologjisë së informacionit, nëpërmjet disiplinave formuese si gjuha e huaj dhe informatika. Në

komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	shkencat humane ka disiplina karakterizuese: Biokimia, Shkenca e të ushqyerit tek njeriu etj. Shtojca 2.7, [Struktura e planit mësimor]. Shtojca 2.8, [Plani mësimor i programit të studimit BCH agroushqim]. Aftësitë e fituara, studentët e demonstrojnë në përgatitjen e prezantimit të detyrave apo projekteve, në vitin e dytë dhe të tretë. Kjo rezultoi dhe nga takimi me studentët.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Aftësitë që fiton studenti janë elemente të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës si një shumatorë e kontrollit të vazhduar. Kontrolli i vazhduar janë: seminare, laboratore, kolektime, detyrë kursit dhe provimi përfundimtar. Shtojca 2.15, [Syllabuset e Programit të studimit BA AGU]. Shtojca 3.8, [Analia Vjetore të njësisë bazë Agroushqim]. Dokument Shtesë Shtojca 6, [Analiza Vjetore e Fakultetit të Bujqësisë 2019-2020].
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.	Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre. Shtojca 3.17, [Model analiza në përfundim të një moduli]. Anketim me studentët e vitit të dytë, në lëndën "Teknologjia e prodhimit të maltit". Në dokumentin e dorëzuar, Shtojca 1.14 [Udhëzimi për përmbajtjen e dosjes së stafit], paraqet se një nga elementët është depozitimi i materialeve në dosjen e pedagogut. Pika q: Testet dhe fondi i pyetjeve për cdo lëndë modul.
Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Në ambientet e departamentit realizohen orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë me tema specifike të cilat kanë interes për studentët. Pedagogët me eksperiencë sëbashku me pedagogët e rinj dhe pedagogë të huaj ose të vendit, paraqesin teknologjitë e reja. Kjo tregohet në dokumentin 3.18, [Shembulli i Orëve të hapura]. Leksion i hapur nga Msc. Franc Kokojka dhe Prof. asoc. Dr Fehmi Xhemo, të shoqëruara me foto.
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Laboratorët dhe praktikat profesionale ndihmojnë studentin në rritjen e aftësive dhe kompetencave profesionale. Kjo paraqitet në Shtojcën 3.25.
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave të caktuara. Përmendim mbledhjet e Dekanatit dhe të Departamentit për miratimin e Analizës vjetore të mësimit, organizimit të mësimdhënies dhe shkencore. Shtojca 3.8, [Analia Vjetore të njësisë bazë Agroushqim]. Shtojca 3.32, [Analiza Vjetore e UNIKO]. Dokument Shtesë Shtojca 6, [Analiza Vjetore e Fakultetit të Bujqësisë 2019-2020].
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	Personeli akademik, krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, të studentëve mbështetur në ato tradicionale autoktone. Personeli akademik mbështet dhe inkurajon zhvillimin e këtyre ideve inovative, të cilat diskutohen, aprovohen financiarisht nga Institucioni dhe më pas zbatohen. Pjesëmarrja në projekte të përbashkëta të personelit akademik me studentët është bashkëpunim i frytshëm.
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e	Në bazë të RVB, ndonëse fondet për studime të avancuara kërkimore

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	dhe shkencore në UNIKO janë të kufizuara, stafi pedagogjik bën kujdes të përfshijë edhe studentët. Kjo u konstatua nga takimet e kryera me pedagogët dhe studentët. Kjo tregohet në dokumentin e dorëzuar Shtojca 4.12 [Lista e pjesëmarrjes së Stafit akademik] dhe studentëve në projekte. Në Shtojcën 4.13, [Temat e diplomave të realizuara studentët].		
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Personeli akademik përveç mbështetjes maksimale që iu jep studentëve, ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione brenda dhe jashtë vendit si dhe biznese me të cilat bashkëpunon për realizimin e praktikave profesionale nga ana e studentëve. Kjo tregohet në shtojcën 3.5, Tabela e Institucioneve bashkëpunuese për praktikant. Universiteti i Korçës është partner në disa projekte Erasmus+, ku 12 studentë të programit të studimit Agrorishqim kanë qenë përfitues të këyre projekteve. Kjo tregohet në Shtojcën 2.10 [Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave] dhe Shtojca 4.12 [Lista e pjesëmarrjes së stafit akademik].		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.8 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Fakulteti i Bujqësisë dhe Departamenti Agrorishqim harton procedurë të posaçme për provimin përfundimtar para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike (ëeb ose në tabelën e njoftimeve në korridore). Për të patur një performancë sa më të mirë në provimin final, studenti njihet me programin e provimit të formimit që në fillim të semestrit të fundit. Kjo paraqitet në Shtojcën 1.2, [Rregullorja e UK, neni 108].
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Sipas rregullores së programit të studimit, Programi i provimit të formimit dhe mbrojtjes së diplomës hartohet nga personeli akademik i njësisë bazë, miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit dhe Dekani i Fakultetit dhe bëhet publike në faqen e internetit. Pedagogët titullarët hartojnë pyetje formuese, të cilat i pasqyrojnë pranë përgjegjësit të departamentit. Shtojca 2.5, [Rregullorja e Programit të Studimit BA AGU. Shtojca 3.29, [Pyetjet e provimit përmbledhës të formimit bachelor].
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Komisioni i posaçëm është i përbërë nga pedagogë të departamentit, të lëndëve që mbulon programi i provimit. Teza e provimit përmban pyetje nga formimi i përgjithshëm dhe ai specifik që përfshihen në programin e provimit, në lidhje me teknologjitë ushqimore. Komisioni përzgjedh pyetjet nga fondi i krijuar në përputhje me peshën specifike të çdo fushe Shtojca 2.5, [Rregullorja e Programit të Studimit BA AGU. Shtojca 3.29, [Pyetjet e provimit përmbledhës të formimit bachelor].
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për	Personeli akademik, i orienton studentët për përzgjedhjen e materialeve të provimit përfundimtar apo të temave të diplomave, duke i ndihmuar

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p>	<p>dhe vënë në dispozicion materiale, informacione shtesë të nevojshme. Materialet studenti i gjen edhe në librarinë universitare ose në sistemin online. Në rregullore e departamentit janë të shprehura të drejtat dhe detyrat e udhëheqësit dhe studentit. Në rastin e temës së diplomës udhëheqësi bashkëpunon me studentin në përcaktimin e temës, hartimin e metodikë dhe në literaturë. Shtojca 2.3, [Rregullorja e njësisë bazë Agroushqim]. Shtojca 2.5, [Rregullorja e Programit të Studimit BA AGU]. Shtojca 4.13, [Tema diplomash të realizuara nga studentët]. Dokument shtesë Shtojca 12, [Temat e Diplomave të mbrojtura në laboratorët].</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Sipas grupit të vlerësimit të brendshëm, UNIKO asiston realisht studentët gjatë kryerjes së analizave, matjeve sin ë mjediset e fakultetit, ashtu edhe në institucione të tjera. Laboratorët e Fakultetit të Bujqësisë janë në dispozicion të studentëve. Fakulteti ka nënshkruar një sërë marrëveshjeshme institucione analoge. Studentët më të dalluar kanë shkuar në universitete të huaja për kërkim ose trajnim në një fushë të caktuar. Këto tregohën në Shtojcën 2.10, [Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale] dhe Shtojcën 4.12 [Lista e pjesëmarrjes së stafit akademik].</p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në përpunimin e temës së diplomës, sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton nëse punimi duhet paraqitur para komisionit. Koha e udhëheqjes së Studentëve Bachelor është nga 7 muaj deri në një vit akademik, kohë nga miratimi në departament i temave dhe udhëheqësve. Shtojca 2.3, [Rregullorja e njësisë bazë Agroushqim]. Shtojca 2.5, [Rregullorja e Programit të Studimit BA AGU]. Shtojca 4.13, [Tema diplomash të realizuara nga studentët]. Dokument shtesë Shtojca 12, [Temat e Diplomave të mbrojtura në laboratorët]. Shtojca 3.28, [Model mikroteze].</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Në përfundim të provimit të formimit osë mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë sipas sistemit shqiptar të vlerësimit me 10-të nota, nga 1-shi tek 10-ta, ku 10-ta është vlerësimi maksimal. Notat nga pesë deri në dhjetë janë kaluese. Shtojca 1.2, [Rregullorja e UK]. Shtojca 2.3, [Rregullorja e njësisë bazë Agroushqim]. Shtojca 2.5, [Rregullorja e Programit të Studimit BA AGU]. Shtojca 2.15, [Syllabuset e programit të studimit BA AGU].</p>
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Sekretaria e Fakultetit të Bujqësisë, pasjis studentin me diplomë dhe suplementin e saj në shqip dhe anglisht të miratuar nga Ministria e Arsimit. Studenti për pajisjen me diplomë duhet të firmosë në listën e protokolluar të diplomave. Kjo tregohet në dokumentin, Shtojca 2.6, [Modeli i diplomës dhe suplementit BA AGU].</p>
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar, nga sekretaria e Fakultetit të Bujqësisë. Kjo tregohet në Shtojcën 3.19, [Model Program i shkurtuar] dhe Shtojcën 2.6, [Modeli i diplomës dhe suplementit BA AGU].</p>
<p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një</p>	<p>Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit</p>

<p>periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.</p>	<p>të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen. Dokumentacioni i dekadës së fundit ndodhet në formë aktive në Sekretarinë e Fakultetit, kurse dokumentacioni më i vjetër është narkivën e Universitetit.</p> <p>Shtojca 1.10, [Rregullore e Sekretarisë mësimore]. Shtojca 2.2, [Rregullorja e njësisë kryesore Fakulteti i Bujqësisë]. Shtojca 2.3, [Rregullorja e njësisë bazë Agroushqim].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>




**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Universiteti “Fan S. Noli”, me anë të Drejtorisë së burimeve njerëzore mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit.</p> <p>Departamenti i “Agroushqimit”, për programet dhe lëndët që menaxhojnë dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore në nivel institucional, mbajnë të dhëna të plota dhe të hollesishme në lidhje me anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrative. Shtojca 1.4, [Rregullore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore].</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit Universiteti “Fan S. Noli”, i ka të përcaktuara në dokumentacionin bazë që rregullon veprimtarinë e Institucionit, parimet, kriteret dhe procedurat për punësimin e personelit akademik efektiv, me kohë të plotë dhe me kohë të pjesëshme.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike. Shtojca 1.13, [Udhëzim Rektorati për Rekrutimin e Stafit]. Shtojca 2.17, [Model Rekrutimi i Stafit Akademik]. Kriteret shpallen publikisht dhe përzgjedhja bëhet me konkurs, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të Institucionit. Shtojca 1.4, [Rregullore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore].</p> <p>Kriteret përcaktohen nga Departamenti në bazë të vendit të punës që kërkohet dhe miratohet nga Dekani dhe i përcillen Rektorit ngazyra e burimeve njerëzore.</p> <p>Për konkursin ngrihet një komision i përbërë nga Zv. Rektori, përgjegjësi i burimeve njerëzore dhe Shefi i Departamentit dhe vlerësohen në bazë të pikëve të kriterëve. Komisioni i paraqet Rektorit pikët e vlerësimit për miratim dhe rektori bën shpalljet përkatëse. Shtojca 3.7, [Raporti Vjetor i NJSBC Fakulteti i Bujqësisë].</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, Universiteti “Fan S. Noli”, ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. Në kriteret e vlerësimit përcaktohen qartë pikët për secilin kriter vlerësimi si diploma e shkollës së larte, gradat, titujt akademikë etj. dhe të përzgjedhur zgjidhen në bazë të këtyre vlerësimeve me pikët më të larta të grumbulluara. Komisioni <i>ad hoc</i> me përfaqësues nga njësia</p>




	bazë, është drejtues i konkursit sipas Ligjit të arsimit të lartë Nr.80/2015 neni 64. Shtojca 1.13, [Udhëzim Rektorati për Rekrutimin e Stafit]. Shtojca 2.17, [Model Rekrutimi i Stafit Akademik].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efikente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Nga shqyrtimi i jeteshkrimeve të stafit, tregohet që personeli i cili mbulon programin e studimit "Agroushqim" është një staf me kualifikimin përkatës për secilin modul. Shtojca 2.9, [Jetëshkrimet e Stafit të Përfshirë në Programin e Studimit]. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. Institucioni i bën të mundur dhe pagesën e vitit sabatik të miratuar nga Departamenti sipas Ligjit të arsimit të lartë Nr.80/2015 neni 63. Nga vizita që u bë në këtë Institucion ambientet fizike ishin të mjaftueshme për kryerjen e proceseve mësimore. Rregulli dhe pastërtia mbizotëronte kudo.
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Gjithashtu Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale, kjo tregohet dhe në mbështetjen financiare me fond të veçantë në buxhetin e miratuar nga Bordi i Administrimit si për Kërkim Shkencor dhe për botimin e librave Shtojca 3.15, [Praktikat e miratimit të buxhetit të UNIKO]. Shtojca 1.12, [Udhëzim për miratimin e teksteve mësimore]. Me anë të projekteve Tempus dhe Erasmus + (International Capacity Building) pedagogët kanë pasur mundësi të shkëmbejnë eksperiencat me pedagogë në Universitete të tjera brënda dhe jashtë vendit. Shtojca 2.13, [Marrëveshjet e Projekteve].
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Institucioni ndjek nje plan trajnimi sipas prioriteteve të tij dhe inkurajon trajnimin dhe promovimin e personelit akademik në Universitete brënda dhe jashtë vendit. Ai mbështet zhvillimin e konferencave shkencore nga njesite bazë, pjesëmarrjen e pedagogëve ne konferenca dhe aktivitete të ndryshme shkencore jashtë vendit. (Shtojca 5.7). Trajnimet zhvillohen në bazë të programit të përcaktuar nga konsorciumi i projektit për lëvizjet e stafit akademik. Gjithashtu ne nivel Departamenti është zhvilluar dhe trajnim i pedagogëve mbi mesimdhënien online.
Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të	Angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të pare tregohet me vlerësimet e performancës së pedagogëve e organizuar nga drejtuesit e

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

studimeve të ciklit të parë.	njësisë bazë, por gjithashtu pyetsorë drejtuar studentëve. Shtojca 3.13, [Model Pyetësor Studentor].		
Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Në përputhje me Vendimin Nr. 418, datë 10.5.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre”, si dhe nga vlerësimi i MASR për kapacitete pritëse të Universitetit “Fan S. Noli” ku bën pjesë dhe Departamenti i “Agroushqimit”, rezulton se Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. Shtojca 1.15, [Raporti i Kontrollit të kapaciteteve të MASR].
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Departamenti i “Agroushqimit” që garanton realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. Departamenti shfrytëzon brenda Fakultetit, salla konferencash ku zhvillohen aktivitete edhe në rang universitetesh, te cilat janë të pajisura me kompjuter, videoprojektor, ekrane të medha, dërrasa të bardha, etj. Ndërkohe, klasat janë të pajisura me të gjitha lehtësirat e nevojshme për të lehtësuar si punën në grupe të mëdha, ashtu dhe atë në grupe të vogla. Kjo u vëzhgua dhe nga vizita që u bë në Institucion.
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Departamenti i Agroushqimit është i pajisur me laboratorë mësimorë dhe kërkimorë shkencorë që përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik. Shtojca 4.7, [Tablela e të dhënave Infrastrukturore]. Nga vizita në Institucion u vërejt që Departamenti ka laboratore mesimore dhe kërkimore shkencore me pajisjet e duhura shkencore si në laboratorin e Mikrobiologjisë Ushqimore me autoklavë, kapë sterile, mikroskopë, gazkromatograf, gjithashtu dhe pajisje për analiza fiziko-kimike të produkteve ushqimore.
Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.	Departamenti i Agroushqimit është i pajisur me një laborator informatike me sipërfaqe 50m ² dhe një sallë internet me sipërfaqe 50m ² . Shtojca 4.7, [Tablela e të dhënave Infrastrukturore].
Kriteri 5. Institucioni garanton, me	Gjithashtu studentëve të këtij Departamenti i ofrohen ambiente nga

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gëm. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	laboratore të sigurisë ushqimore, apo njësi prodhimi të produkteve ushqimore, fabrika të përpunimit të produkteve ushqimore për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Shtojca 4.7, [Tabela e të dhënave Infrastrukturore]. Shtojca 3.5, [Tabela e Institucioneve Bashkëpunues për Praktikën]. Te gjithë këto facilitate ndihmojnë shumë zhvillimin e kompetencave praktike të studenteve.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Universiteti “Fan S. Noli”, vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit, siç është literaturë bazë, atyre ndihmëse, revistave të ndryshme shkencore në gjuhën shqipe dhe të huaja.
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka është e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. Biblioteka është e pajisur me rreth 22 mijë libra e revista, nga të cilët 3 mijë në gjuhë të huaja dhe 19 në gjuhën shqipe. Shtojca 4.10, [Të dhëna për fondin e librave në fakultet]. Biblioteka është e mjaftueshme me numrin e madh të librave që ka por pasurimi i mëtejshëm i saj gjithnjë e më shumë me literaturë bashkëkohore do ndihmonte më shumë pedagogët dhe studentët për tu njohur me të inovacionet e fundit.
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Aktualisht funksionon biblioteka dixhitale "U-library" e ngritur në bashkëpunim me RASH e cila ofron aksesin në EBSCO për stafin akademik dhe studentët e këtij Universiteti. Universiteti “Fan S. Noli” ofron Bibliotekën digjitale Pro-Quest deri mënga 1 Marsi deri më 28 shkurt 2019, ku studentëve i ofrohet akses i barabartë e pa pagesë. Sugjerojmë që kjo kontratë të vazhdojë dhe në të ardhmen
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Biblioteka është e pajisur me kompjutera dhe internet, sistem ngrohje dhe fotokopje për materiale të ndryshme mësimore, të cilat shfrytëzohen nga studentët me akses të barabartë, të cilëve i është sugjeruar dhe nga pedagogët e lëndëve përkatëse.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Departamentet propozojnë cdo vit para miratimit të buxhetit, kërkesat për literaturë bazë dhe atë ndihmëse dhe i vihen në dispozicion bibliotekës për pasurimin me libra, revista dhe buletine të reja. Shtojca 3.15, [Praktikat e miratimit të buxhetit UNIKO].. Kjo bibliotekë është e pasuruar dhe nga fond librash të dhuruar nga MASR. Fondi i dhuruar nga MASR është prej 300 librash.		
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka është e hapur nga ora 8.00 deri në orën 16.00 nga e Hëna në të Premte, një orar i mjaftueshëm për shfrytëzimin e saj nga studentët e këtij Universiteti, duke shërbyer gjithashtu si një sallë studimi për studentët e këtij Universiteti.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht
			X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Universiteti “Fan S. Noli”, ashtu si dhe Universitetet e tjera në vendin tonë disponon sistem të menaxhimit ESSE3, nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. Me anë të këtij sistemi studentët informohen për datat e provimeve, për prenotimet e provimeve dhe notat që marrin në lëndë të ndryshme. (Shtojca 5.4)
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Të gjithë informacionet mbi dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit gjenden në këtë sistem të menaxhimit të brendshëm. Gjithashtu studentët informohen on line mbi aktivitete të ndryshme të organizuara nga Departamenti. (Shtojca 5.4). Perveç mbajtjes se rekordeve nga ana e sekretarise ne forme fizike, sekretarite jane pergjegjese edhe per mbajtjen e ketyre rekordeve ne formen elektronike
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Me anë të këtij sistemi të menaxhimit të brendshëm studentët informohen për datat e provimeve, për prenotimet e provimeve dhe notat që marrin në lëndë të ndryshme, për datat e mbrojtjeve të diplomave apo provimeve të formimit (Shtojca 5.4, 5.5)
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Sistemi i menaxhimit ESSE3 ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet pedagogëve dhe studentëve. Studentët informohen për notat që marrin pa patur në kohë reale online (Shtojca 5.4, 5.5).

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Për organet drejtuese dhe titullarë, sistemi i menaxhimit ESSE3 mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale on line si dhe garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ. Në këtë system janë të gjithë të dhënat e stafit akademik, atij drejtues, dhe administrativ (Shtojca 5.4, 5.5).		
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Universiteti "Fan S. Noli", në zbatim të nenit 4, të Ligjit nr. 119/2014 "Mbi të drejtën e informimit", publikon në faqen zyrtare, nformacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe. Shtojca 2.18, [Ligji për të drejtën e Infomimit]. Shtojca 5.1 [Link].		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Në Universitetin "Fan S. Noli", hartohet një plan financiar nga Drejtoria Financiare dhe Drejtoria Ekonomike për një nje plan buxhetor afatmesëm, i cili përditësohet çdo vit, duke marrë parasysh kërkesat financiare të Departamentit të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit. Shtojca 1.8, [Rregullore e Drejtorisë Financiare].
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.	Nga shqyrtimi i planit të buxhetit të Universitetit "Fan S. Noli", Plani i financimit të programit të studimitpërmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzime për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij. Shtojca 1.7, [Rregullore e Drejtorisë Ekonomike]. Shtojca 1.8, [Rregullore e Drejtorisë Financiare].
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve	Universiteti "Fan S. Noli", kryen auditim të brendshëm, të përvitshëm. Kontrolli dhe auditimi i brendshëm realizohen nga njësia e auditimit të brendshëm të Universitetit. Perbërja dhe mënyra e funksionimit të kësaj njësie përcaktohet në rregulloren perkatese të saj të miratuar nga Bordi i Administrimit. Universiteti "Fan S. Noli", kryen auditim të brendshëm të pavarur. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare. Raportet e auditit të pavarur pasqyrojnë

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

financiare.	ndarjen e shpenzimeve sipas kategorive kryesore: paga, qira, shpenzime administrative, shpenzime për kërkim zhvillimi etj. sipas përcaktimeve me akte ligjore. Shtojca 1.7, [Rregullore e Drejtorisë Ekonomike].			
Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	Në Universitetin “Fan S. Noli”, dokumentohen raportet financiare për tri vitete kaluara akademike dhe planifikohen ndërhyrjet e posaçme të financimit të programit, i cili përditësohet duke marrë parasysh kërkesat financiare të Departamentit të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit. Shtojca 1.7, [Rregullore e Drejtorisë Ekonomike]. Shtojca 1.8, [Rregullore e Drejtorisë Financiare].			
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	Me anë të parashikimit të një plan buxheti Universiteti “Fan S. Noli”, garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen. Shtojca 1.7, [Rregullore e Drejtorisë Ekonomike]. Shtojca 1.8, [Rregullore e Drejtorisë Financiare].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1				
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Drejtoria e Kurrikulave, Sigurimit të cilësisë dhe kërkimit shkencor, ndjekin procesin mësimor dhe zhvilliminë karrierës për ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje. QKA orienton dhe këshillon studentët nga cikli i parë i studimit në ciklin e dytë dhe të tretë, dhe orienton studentët për daljeve tyre në tregun e punës (Shtojca 1.5, [Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulave]).			
Kriteri 2. Politikatat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Në Shtojcën 2.2, [Rregullore e njësisë kryesore të FB], paraqet se në Departamentin e Agroushqimit, ofrohen lloje të ndryshme bursash, si bursa sociale për shtresat në nevojë, bursa të pjesshme, bursa ekselence për studentët me rezultate të larta gjatë studimeve etj. Në programin e studimit, të ofruar nga departamenti, si pjesë e FB, pranohen për t'u regjistruar shtetasit shqiptar ose të huaj që plotësojnë kushtet.			
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Në programet e studimit të ciklit të parë pranohen kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm të përgjithshëm apo profesional dhe kur kanë përfunduar jo më pak se 12 vjet shkollë në ciklet parauniversitare. Pranohen edhe kandidatët që kanë marrë një diplomë të shkollës së mesme jashtë vendit. Për këtë kërkohet që të jetë bërë ekuivalentimi i diplomës së fituar prej tyre në vendin e huaj nga komisioni përkatës në MASR. Kandidatët plotësojnë kriterin e meritës dhe kriterin e rëndësisë.			
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	Në bazë të RVB, Fakulteti iu mundëson transferime studentëve që ende nuk kanë përfunduar studime në programet që ofrohen. Kjo tregohet në Shtojcën 4.5 [Tabela transferimi].			
Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Në çdo vit akademik Senati, i propozon për miratim MAS kriteret e pranimeve të aplikantëve/maturantëve për të vijuar studimet në UNIKO. Në këtë kuadër, pranë shkollave të mesme promovohet njësia, programet e studimit që njësia ofron si edhe jepet informacion rreth kriterëve të pranimit. Kjo tregohet në Shtojcën 3.10, [Praktika e informimit të maturantëve].			
Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Në rregulloren e FB, si edhe në rregulloren e studimeve të DT AGU, parashikohen dhe përshkruhen në mënyrë të qartë, procedurat e pranimit të studentëve. FB-ja në bashkëpunim me QKA, çdo vit përgatit paketën e informacionit orientues për aplikantët/maturantët të interesuar për të aplikuar në programin e studimit. Në Website të INKO janë të publikuara programet e studimit, kuotat si edhe kriterëve të pranimit. Kjo tregohet në Shtojcën 5.1. Në fakultet organizohen edhe ditë të hapura me maturantët për të informuar rreth programeve të studimit, këshillimit të karrierës dhe mundësitë për punësim. Kjo tregohet në Shtojcën 5.9. Në Shtojcën 3.10 paraqitet Praktika e informimit të maturantëve nëpërmjet veprimtarive me shkolla të mesme të qytetit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Standardi V.2**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Informacioni për mësimdhënien dhe mësimnxënien mbi programin e studimit publikohet në faqen e internetit të institucionit. Gjithashtu në faqen e internetit hidhen rregulloret dhe informacioni për njësinë bazë dhe janë të disponueshme në sistemin digital ESSE3 të Universitetit. (Shtojca 5.1 dhe Shtojca 5.4). Shtojca 2.5 paraqet Rregulloren e programit të studimit BA AGU, e cila përfshin: informacion të përgjithshëm të kurrikulës, mësimdhënies dhe mësimnxënies, vlerësimit, pranimeve, infrastrukturës, si dhe mundësive për punësim. Gjithashtu, një detyrim i përcaktuar në rregulloren e fakultetit dhe të departamentit përgjegjës për programin e studimit është se: Pedagogu i lëndës paraqet tek studentët, strukturën e lëndës, në bazë të syllabusit dhe planit kalendar, ku përfshihen temat që do të trajtohen gjatë modulit, mënyra e vlerësimit të studentëve. (Shtojca 2.3 [Rregullorja e njësisë bazë Agroushqim] dhe Shtojca 2.5 [Rregullore e Programit të studimit])
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.	Fakulteti i Bujqësisë ofron mundësi për ekuivalentimin e programeve të studimit ose diplomave. Fakulteti ofron mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve, brenda UNIKO apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë dhe lejon largimin e studentëve të tij për në universitetet të tjera, sipas procedurave të parashikuara. Studentët informohen dhe orientohen në lidhje me mundësinë e transferimit të programeve të studimeve apo të krediteve të fituara gjatë zhvillimit të tyre nëpërmjet sekretarive mësimore të UNIKO dhe Fakulteti. Kjo tregohet në Shtojcën 2.2, [Rregullore e njësisë kryesore Fakulteti i Bujqësisë, Kreu IX, Transferimet, Njohja e krediteve dhe ekuivalentimi i moduleve, neni 97-105].
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Bazuar në rregulloren e UNIKO dhe FB, departamenti bën të njohur kriteret dhe procedurat e diplomimit, duke i afishuar në mjediset e fakultetit ose në faqen e fakultetit. Procedurat dhe modalitetet e mbrojtjes së diplomës shprehen në Shtojcën 1.2 [Rregullore e UK], neni 108. Rregullorja e diplomimit, pjesë e rregullores së departamenteve, Shtojca 2.3 [Rregullorja e njësisë bazë Agroushqim]. Një ditë pas shpalljes së rezultateve të provimit pranohen dhe vlerësohen ankesat e studentëve.
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Në rregulloren e FB dhe DT AGU paraqiten kriteret e nevojshëm që duhet të plotësoj një student para se të hyjë në provimin e formimit dhe mbrojtjen e temës së diplomës. Në këto rregullore pasqyrohen qartë procedurat dhe sanksionet para provimit të formimit dhe temës së diplomës. Departamenti nëpërmjet sekretarisë mësimore informon studentët e vitit të fundit rreth procesit dhe procedurave të provimit të

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

	<p>formimit dhe temës së diplomës.</p> <p>Në shtojcën 2.2, [Rregullorja e njësisë kryesore Fakulteti i Bujqësisë, Neni 67, Diplomimi i studentëve të programit të ciklit të parë “Bachelor”] paraqitet se:</p> <p>Studentët në programet e ciklit të parë të studimeve “Bachelor” në FB diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome, kur plotëson kriterin e notës mesatare të vendosur nga njësia bazë. Departamenti përcakton kriteret dhe standardet e përgatitjes së një punimi diplome të nivelit të parë, rë rregulloren e diplomimit. Udhëheqësi i punimit të diplomës përgatit programin e punës së studentit. Tema e diplomës vlerësohet nga një pedagog oponent. Programi i provimit të përgjithshëm është gjithëpërfshirës, me tematikat nga fushat kryesore që përmban programi i studimit. Provimi realizohet përpara një komisioni të posaçëm.</p> <p>Në shtojcën 2.3, [Rregullorja e njësisë bazë Agroushqim, Neni 23, Kushtet e kalimit në vitin pasardhës dhe të diplomimit] paraqitet se:</p> <p>Studenti i vitit të tretë me kohë të plotë që në përfundimin e studimeve ka grumbulluar 180 kredite, ka të drejtë të paraqitet në provimin e formimit (sezonin e diplomimit muaj korrik). Studenti i vitit të tretë me kohë të plotë që nuk plotëson kriteret për t’u paraqitur në provimin e formimit pasi ka detyrime të pashlyera duhet të shlyejë detyrimet e prapambetura në sezonet pasardhëse dhe duhet të paguajë kreditet për modulet e pashlyera.</p> <p>Studentët të cilët kanë përfunduar të gjitha detyrimet pajisen me diplomë. Diploma miratohet nga Senati Akademik. Diploma shoqërohet me listën e notave dhe suplementin, sipas modelit të miraturar.</p>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, Qendra e Karrierës dhe Alumni, njësi strukturore e administratës së UNIKO publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. Kjo tregohet në Shtojcën 3.10 [Praktika e Informimit të maturantëve], Praktika e informimit të studentëve dhe Shtojcën 5.9.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Studentet mund të marrin informacionin nëpërmjet Website të UNIKO ose pranë sekretarive studentore. Studentët informohen rreth rregullores së programit të studimit, rregullores të fakultetit, me anë të fletëpalosjeve dhe broshurave informohen për strukturën, organizimin dhe programin e studimit, kreditet përkatëse dhe kohëzgjatjen e rregullt të studimeve. Kohëzgjatja normale e studimeve është 3 vite akademike.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>Programet e studimit janë të organizuara në module dhe të vlerësuara me kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Studenti në përfundim të programit të studimit duhet të grumbullojë 180 kredite.</p> <p>Shtojca 2.2 [Rregullore e Njesisë Kryesore Fakulteti i Bujqësisë, neni 49] dhe Shtojca 2.3 [Rregullorja e njesisë bazë Agrorshqim].</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Qendra e Karrierës dhe Alumni mbështet studentët gjatë gjithë jetës së tyre studentore në këtë program studimi. Në çdo fillim viti akademik Fakulteti i Bujqësisë dhe Departamenti Agrorshqim vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacionin rreth planit mësimor, orari, praktikat profesionale, kreditet, semestri kur zhvillohet moduli, etj. Ky informacion mund të gjendet pranë sekretarisë mësimore të departamentit në formë elektronike dhe fizike dhe në faqen e UNIKO. Kjo tregohet në dokumentin Shtojca 3.11 [Praktika e informimit të studentëve me programin e studimit] dhe Shtojca 5.8.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Cdo student është i pajisur me dosje personale, e cila administrohet nga sekretaria mesimore dhe përditësohet vazhdimisht. Qendra e Karrierës dhe Alumni, Departamenti dhe Universiteti orienton studentët për daljen e tyre në tregun e punës dhe i ndjek ata edhe pas përfundimit të studimeve. Kjo tregohet në Shtojcën 4.6, Tabela e të dhënave për punësimin e studentëve të programit të studimit Bachelor për vitin 2017-2018.</p> <p>Në Shtojcën 3.10, [Praktika e informimit të maturantëve], tregohet veprimtaria promovuese e Universitetit “Fan S. Noli” në gjimnazet e Qarkut të Korçës. Veprimtaria “Ditët e hapura me maturantët” është e rëndësishme për afrimin e studentëve të ardhshëm me Universitetin.</p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Në Fakultetin e Bujqësisë është ngritur një sistem për të transmetuar tek studentët të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programet e studimit, procesin mësimor, rregulloren e brendshme të institucionit, rregulloren e studimeve, procedurat në lidhje me aktivitetet të ndryshme të procesit mësimor. Kjo tregohet në dokumentin Shtojca 3.11 [Praktika e informimit të studentëve me programin e studimit]</p>			
<p>Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe është lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance. Kjo mundësohet nëpërmjet: faqes së Fakultetit dhe të pedagogut, ku gjenden: Programi i Studimit, Syllabuset, Përmbajtja e moduleve, orari mësimor etj.; Orareve të pritjes të përcaktuara në syllabusin e cdo lënde dhe Numrit të telefonit. Kjo tregohet në Shtojcën 5.1.</p>	<p>Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe është lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance. Kjo mundësohet nëpërmjet: faqes së Fakultetit dhe të pedagogut, ku gjenden: Programi i Studimit, Syllabuset, Përmbajtja e moduleve, orari mësimor etj.; Orareve të pritjes të përcaktuara në syllabusin e cdo lënde dhe Numrit të telefonit. Kjo tregohet në Shtojcën 5.1.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi. Sekretaria mësimore pranë njësisë bazë, realizon procedurën e regjistrimit sipas Rregullores së sekretarive mësimore. Kjo tregohet në Shtojcën 1.10. [Rregullorja e Fakultetit të Bujqësisë], përcakton regjistrimin, ruajtjen e të dhënave dhe statistikave vjetore për të diplomuarit, sipas rregullores për mbrojtjen e të dhënave personale. Kjo tregohet në Shtojcën 1.9. Komunikimi me studentët zhvillohet me emailin e universitetit, me numër telefoni dhe nëpërmjet orareve të pritjes të përcaktuara në syllabus. Në Shtojcën 4.4, paraqitet Tabela e të dhënave të regjistrimit dhe ecurisë së studentëve në hyrje dhe në dalje.
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.	Studentë të rregjistruar total në Bachelor Agroushqimor: 2016-2017 të rregjistruar 15 studentë; 4 studentë të transferuar për brezat; Gjithsej 40 studentë 2017-2018 të rregjistruar 18 studentë; 28 studentë të transferuar për brezat; Gjithsej 46 studentë dhe 2018-2019 të rregjistruar 36 studentë; 0 studentë të transferuar për brezat; Gjithsej 36 studentë Numri i Studentëve të Diplomuar në Bachelor: Numri total i studentëve të diplomuar janë 80 studentë. Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën) janë 10 dhe Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën) janë 10. GVJ zhvilloi takim në Sekretarinë mësimore dhe pa afër Rregjistrin Themeltar të studentëve, Rregjistrin e notave dhe atë të diplomimit. Zyra e sekretarisë mësimore ruan informacion për ecurinë e studentit nga njëri vit akademik në tjetrin deri në diplomimin e tyre. Zyra studentore bën regjistrimin e studentëve dhe mbajtjen e bazës së të dhënave mbi studentët dhe rezultatet e tyre, në formë shkresore dhe elektronike; mban dokumentacionin mbi procesin mësimor dhe ndjek ecurinë së procesit mësimor; Plotëson dhe dorëzon diplomat; Plotëson dhe dorëzon diplomat suplement; Lëshon vërtetim me foto si dokument zëvendësues për diplomën; Lëshon vërtetim mbi ciklin e studimeve dhe e shoqëron atë me listën e notave; Harton pasqyrën e rezultateve të detyrimit dhe provimit në bashkëpunim me departamentet; U jep informacion studentëve lidhur me kërkesat e tyre për transferim nga një fakultet në tjetrin.
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Orientimi dhe këshillimi i studentëve realizohet përmes Qendrës së Karrierës dhe Alumni, sekretarisë mësimore (Shtojca 3.11, [Praktika e Informimit të Studentëve me Programin e Studimit]) dhe Njësisë Bazë (Shtojca 1.5, [Rregullore e drejtorisë së Kurrikulave]). Të dhënat statistikore gjenden në dy forma në atë të shkruar dhe atë të dixhitalizuar. QKA funksionon si një zyrë për të ndihmuar nxënësit nga gjimnazi



	derisa të hedhin hapat e para profesionale. Kjo qendër mban lidhje të vazhdueshme për ecurinë profesionale të ish- studentëve të saj.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Komunikimi i brendshëm i akteve, njoftimeve realizohet përmes shpërndarjes së tyre tek organet, autoritet drejtuese apo të gjithë personelit akademik dhe administrativ. Komunikimi i brendshëm mund të jetë verbal ose virtual. Departamenti mbledh të gjithë informacion nga zyra e sekretarisë mësimore dhe përpilon raportin periodik mësimor dhe atë kërkimor. Në këtë raport paraqiten të detajuar problematikat që lidhen me: studentët e rinj plotësimin e kritereve sipas vitit akademik; ecurinë dhe kalueshmërinë e studentëve; mundësitë e punësimit sipas kërkesave të tregut për specialistë në fushën e ushqimit, reflektimin lidhur me problematikat e hasura për realizimin e objektivave të ndërrmarra në fillim të vitit akademik dhe marrjen e masave për realizim e tyre në vitin pasardhës. Këto raporte pasqyrohen në analizën vjetore të Fakultetit të Bujqësisë. Kjo tregohet në dokumentin Shtojca 4.6, [Tabela e të dhënave për punësimin e studentëve të programit të studimit].			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Bazur tek Ligji i Arsimit të Lartë 80/2015, është ngritur Këshilli i Studentëve (Shtojca 1.17, [Rregullore e Këshillit studentor]). Studentët kanë të drejtë të shprehin vlerësimin e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit në institucionin e arsimit të lartë (Shtojca 1.17, [Rregullore e Këshillit studentor], neni 2) Sipas GVB, Studentëve iu garantohej e drejta për tu përfshirë vendimmarrje, këshillim apo vlerësim, si dhe të tjera që përcaktohen në Rregulloren e Universitetit dhe Njësisë Kryesore (Shtojca 1.1, [Statuti i UK] neni 68,69, dhe Shtojca 2.2, [Rregullore e njësië kryesore të Fakultetit të Bujqësisë] Kreu 12). Studentët përfshihen në Senatit akademik (Shtojca 1.11 [Rregullore e Senatit Akademik]); për zgjedhjen e autoriteteve dhe organeve drejtuese 1.19, në Këshillin e etikës (Shtojca 1.19 [Rregullorja për Organizimin e zgjedhjeve UNIKO] dhe Shtojca 1.1 [Statuti i UK], neni 23); në njësitë për sigurimin e cilësisë (Shtojca 3.4 [Lista e NJSBC]) etj. Të gjitha dokumentat e përmendura mësipër janë dorëzuar. Në Shtojcën 1.1, [Statuti i UK] , Neni 10 tregon se kërkohet pjesëmarrja e studentëve në përbërjen e Senatit Akademik në masën 10%; në Komisionine Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor dhe Komisionit të Etikës, në rang Fakulteti dhe Universiteti. Gjithashtu, lidhur me nismën Pakti për Universitetin të vitit 2019, studentët ju jepet e drejta të përfaqësohen me një anëtarë të zgjedhur edhe në Bordin e Administrimit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm sugjeron të merren për bazë këto pjesëmarrje.
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të	Bazuar në rregulloren e departamentit, departamenti merr parasysh

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>ngarkesën akademike të studentëve. Programi i Studimit në departamentin Agroushqim zhvillohet në harkun kohor të tre viteve akademike, gjashtë semestre dhe në fund të vitit të tretë provim formimi për diplomim dhe temë diplome. Një vit akademik përmban gjithsej 60 kredite, të ndara nga 30 kredite për semestër, dhe tre vitet përmbajnë 180 kredite gjithsej (Shtojca 2.7). Sipas RVB, ngarkesa akademike për këtë cikël studimi është:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 1174 orë leksione - 924 orë seminare, ushtrime, punë laborator - 150 orë teza e diplomës - Provim për çdo lëndë <p>Shpjegimi në Shtojcën 3.1. Shuma e përgjithshme e orëve të mësipërme është 2268.5 orë, e barabartë me 180 kredite. Për të gjithë studentët që kërkojnë të transferojnë studimet ose kërkojnë të vazhdojnë një program të dytë studimi të njëjtë ose të ngjashëm, bëjnë ekuivalentimin e moduleve ose programeve të plota të studimit ose diplomave të marra në institucione të tjera të vendit ose të huaja mbas paraqitjes së kërkesës dhe dokumentacionit të nevojshëm nga të interesuarit. Kjo tregohet në Shtojcën 4.5, Tabela e Transferimeve të studentëve dhe nga programi i studimit. Gjithashtu, duhet të përmendet Shtojca 2.2, [Rregullore e njësisë kryesore të FB], Kreu IX, Transferimet, njohja e krediteve dhe ekuivalentimi i moduleve.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Në bazë të dokumentave të dorëzuar Shtojca 1.1 [Statuti i UK] dhe Shtojca 2.2 [Rregullore e njësisë kryesore të FB], Studentët shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të institucioneve të arsimit të lartë, si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, përcaktimin e tarifave të shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj. Sipas rregullores së studimeve, në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, organizohet pyetësori studentor për cilësinë e mësimdhënies për modulet e çdo programi studimi</p>
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. Kjo tregohet në Shtojcën 1.2 [Rregullorja e UK], neni 103.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Studenti ka të drejtë të ankohet në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat procedurale gjatë zhvillimit të provimit ose nuk është dakord me vlerësimin e bërë. Ankesa bëhet me shkrim brenda ditës së marrjes së rezultatit për provimin me gojë dhe jo më vonë se 8 ditë për provimin me shkrim, nga data e dhënies së tij dhe i drejtohet dekanit të fakultetit. - Kjo ankesë shqyrtohet nga Dekani, i cili mund të thërrasë për sqarime përgjegjësin e departamentit përkatës, komisionin e provimit si dhe vetë studentin. - Dekani përcakton nëse ankesa e studentit është e drejtë apo jo dhe merr vendimin përkatës. - Kur ankesa është e drejtë, Dekani e shpall të pavlefshëm rezultatit e vlerësimit për të cilin studentit është ankuar dhe vendos në bashkëpunim me përgjegjësin e Departamentit, që studentit të rijapë provimin.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.6				
Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Institucioni vë në dispozicion të studentëve broshura mbi, programet e studimit dhe aktivitetin e tij. Kjo tregohet në Shtojca 3.10, [Praktika e promovimit dhe informimit të maturantëve], ku shprehen pikat e forta dhe të dobëta. Për realizimin e kësaj veprimtarie është angazhuar Qendra e Karrierës dhe Alumni në bashkëpunim me njësinë bazë të Universitetit "Fan S. Noli". Hapat e punës: Hartimi i fletëpalosjes, Hartimi i grafikut për zhvillimin e ditëve të promovimit, Zhvillimi i ditëve të promovimit në gjimnaze dhe Zhvillimi i ditëve të hapura. Një mundësi informimi është faqja zyrtare www.uniko.edu.al .			
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Drejtoria e Kurrikulave, Sigurimit të cilësisë dhe kërkimit shkencor ndjekin procesin mësimor për ciklin e plotë akademik të studentëve nga fillimi deri në përfundim të programit të studimit Bachelor. Kjo degë është pjesë përbërëse e strukturës organizative të UNIKO dhe funksionon si njësi ndihmese e rektoratit. Kjo tregohet në Shtojcën 1.5, [Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulave]. Qendra e Karrierës dhe Alumni orienton dhe këshillon studentët nga cikli i parë i studimit deri në ciklin e tretë, orienton studentët për praktikën profesionale, orienton studentët për daljen e tyre në tregun e punës dhe i ndjek ata edhe pas përfundimit të studimeve. Kjo paraqitet në Shtojcën 1.5 [Rregulloren e Drejtorisë së kurrikulave, sigurimit të cilësisë dhe kërkimit shkencor] dhe Shtojcën 3.11 [Praktika e Informimit të Studentëve me Programin e Studimit].			
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. Kjo tregohet në Shtojcën 4.6 [Tabela e të dhënave për punësimin e studentëve të programit të studimit Bachelor] dhe Shtojcën 3.12 [Studim tregu shembull të dhëna për punësimin e studentëve].			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. Kjo tregohet në Shtojcën 4.6 [Tabela e të dhënave për punësimin e studentëve të programit të studimit Bachelor] dhe Shtojcën 3.12 [Studim tregu shembull të dhëna për punësimin e studentëve].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1			
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë			
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve		
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Universiteti “Fan S. Noli” ka politika, për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. Struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, ka të bëjë më gjerë e një njësie të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në përputhje me aktet ligjore. Shtojca 3.7, [Raporti Vjetor i NJSBC Fakulteti i Bujqësisë].		
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorët e ekspertë të jashtëm.	Universiteti “Fan S. Noli” përdor metodologji vlerësimi për veprimtaritë me karakter kontrolli që organizohen nga njësitë e Brëndëshme të Sigurimit të Cilësisë, për secilin nga proceset akademike që kontrollohen gjatë vitit dhe rezultatet në shkallë Fakulteti raportohen pranë kësaj njësie në shkallë Universiteti. Gjithashtu rekomandon detyra, zbatimi i të cilave ndiqet nga ana e strukturave drejtuese dhenjësisë së brendëshme të sigurimit të cilësisë. Shtojca 3.4, [Lista e NJSBC]. Shtojca 3.7, [Raporti Vjetor i NJSBC Fakulteti i Bujqësisë].		
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	Universiteti “Fan S. Noli” realizon Sigurimin i Jashtëm të Cilësisë në përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese. Me anë të vlerësimeve të jashtëme ky Institucion bën përmirësimet e duhura për sigurimin e cilësisë dhe sigurisë të arsimit të lartë. Programi i studimit të Agroushqimit riorganizohet duke synuar përmirësimin e vazhdueshëm të tij. Shtojca 3.31, [Kalendari i Veprimtarisë së SKCS NJBC]. Sektori i kurrikulave dhe sigurimit të cilësisë përveç anketimit të studentëve përdor dhe vlerësimin e jashtëm nga vlerësuesit e jashtëm të akreditimit, vlerësimin krahasues dhe analitik me institucione të tjera të ngjashme me qëllim përmirësimin e cilësisë. Shtojca 3.7, [Raporti Vjetor i NJSBC Fakulteti i Bujqësisë].		
Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.	Universiteti “Fan S. Noli” ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Njësia e sigurimit të cilësisë së brendëshme kryen në menyre të rregullt vlerësimin e veprimtarisë akademike dhe administrative përmes metodash të tërthorta, kryesisht në formen e sondazheve me pyetorë me studentët, për lendët dhe pedagogët. Rezultatet përpunohen në mënyrë periodike. Shtojca 3.7, [Raporti Vjetor i NJSBC Fakulteti i Bujqësisë] Updatimi me kurrikulat e Universiteteve jashtë dhe brënda vendit, vlerësimi krahasues dhe analitik me këto institucionetë ngjashme do të ndikojnë shumë nëpërmirësimin e cilësisë.		
Shkalla e përmbushjes së	Nuk	Përmbushet	Përmbushet

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

standardit	plotësisht	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	Universiteti “Fan S. Noli” ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë. Kjo arrihet me anë të Sektorit të Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilesisë. Ky sektor përfshin dy drejtime: Zhvillimin e programeve mesimore dhe Vlerësimin Institucional. Shtojca 3.31, [Kalendari i Veprimtarisë së SKCS NJBC]. Ky sektor ndjek zbatimin e bazës ligjore në fuqi që nga hapja, riorganizimi apo mbyllja e programeve të studimit.
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Sektori i kurrikulave dhe Sigurimit të cilësisë menaxhon Sigurimin e Cilësisë në shkallë Fakulteti dhe Universiteti dhe funksionon i mirë kordinuar me njësinë bazë dhe menaxhimin e burimeve njerëzore. Shtojca 3.31, [Kalendari i Veprimtarisë së SKCS NJBC]. Disa nga keto mekanizma qe mund te jene sugjerimet e cdo pedagogu, sugjerimet nga studentet ne pyetsore.
Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	Sektorit i Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilesisë të Universiteti “Fan S. Noli” përdor metodologji vlerësimi, krahasimi me Institucione të tjera për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve. Studentë nga Këshilli studentor bëhen gjithashtu pjesë e takimeve për sondazhin e studentëve. Fakulteti merr feedback dhe nga takime me ish studentë të cilët janë punësuar në sektorin Agroushqimor. Shtojca 3.31, [Kalendari i Veprimtarisë së SKCS NJBC].
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Nga sondazhet e vazhdueshme të bëra nga njësia bazë nxirren problematikat dhe bëhen përmirësimet e duhura, si organizmi i praktikave, performanca e pedagogëve, literature e nevojshme, komunikimi pedagog student etj. Rezultatet e vlerësimit të brëndëshëm paraqiten me anë të një raporti i cili kryhet nga Njësia e Sigurimit të cilësisë në bazë të statutit të Universitetit neni 62. Qëllimi i këtij raporti është që të sigurojë vlerësim korrekt të bazuar në tregues realë dhe të matshëm për garantimin e cilësisë së programit të studimit. Shtojca 3.7, [Raporti Vjetor i NJSBC Fakulteti i Bujqësisë].
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	Raportet e vlerësimit përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë. Rezultatet përpunohen në raporte periodike, rekomandohen detyra, zbatimi i të cilave monitorohet nga njësia bazë. Gjithshtu nxirren konkluzione mbi veprimtarine e secilit staff të njësisë bazë. Shtojca 3.13, [Model Pyetësor Studentor].
Shkalla e përmbushjes së	Plotësisht Përmbushet pjesërisht Përmbushet kryesisht Përmbushet plotësisht

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Shqyrtimi i shtojces 4.6 jep informacion mbi Vlerësimin e brendshëm të programit të studimit i cili kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike. Në mënyrë periodike merren informacion mbi punësimin e studentëve të cilët kanë mbaruar studimet në Departamentin e Teknologjisë Agrorshqimore pranë Universitetit “Fan Noli” Korçë.</p> <p>Në vlerësimin e brendshëm paraqiten te gjithë hapat e vetëvlerësimit si Identifikimi i qëllimi, Rezultateve, Masat dhe hartimi i vlerësimit, Mbledhja e të dhënave, Analiza dhe vlerësimi, Krahasimi i të dhënave me standartet e cilësisë, si dhe vendimarrja për masat e marra.</p> <p>Në shtojcën 1.16 dhe 4.6 janë pasqyruar në mënyrë periodike këto vetëvlerësime të brendshme. Shtojca 1.16, [Manuali i Cilësisë së UK 2020]. Shtojca 4.6, [Tabela e të dhënave për punësimin e studentëve].</p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit. Këto metoda përfshijnë pyetorë të ndryshëm të kryer ndaj studentëve të cilët janë aktualisht në studime ose ato të cilët kanë mbaruar studimet.</p> <p>Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë përgatit çdo vit vlerësime të cilësisë. Synimi i këtij vlerësimi është garantimi i standarteve të cilësisë dhe është përgjegjës për politikën e vlerësimit dhe zbatimin e procedurave të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Këto vlerësime raportohen në Institucion. Shtojca 3.7, [Raporti Vjetor i NJSBC Fakulteti i Bujqësisë].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Departamentin e Teknologjisë Agrorshqimore pranë Universitetit “Fan Noli” Korçë është përgjegjës për mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit duke përdorur metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare. Kjo në përputhje me Ligjin të arsimit të lartë Nr.80/2015.</p> <p>Këto metoda kryhen në Departament dhe pasqyrohen qartë në shtojcën Shtojca 1.16, [Manuali i Cilësisë së UK 2020]. Shtojca 3.7, [Raporti Vjetor i NJSBC Fakulteti i Bujqësisë].</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes</p>	<p>Në shtojcën 3.7 [Raporti Vjetor i NJSBC Fakulteti i Bujqësisë].</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>tregohet që, Departamenti i Teknologjisë Agroushqimore pranë Universitetit “Fan Noli” Korçë në kuadër të vlerësimin të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p> <p>Këto paraqiten periodikisht në kalendarin e veprimtarive të Sektorit të Kurrikulave dhe Sigurimit të cilësisë dhe në raportimet e bëra nga grupi i Vlerësimin të brendshëm të cilësisë. Shtojca 3.7, [Raporti Vjetor i NJSBC Fakulteti i Bujqësisë]. Shtojca 3.31, [Kalendari i Veprimtarisë së SKCS NJBC].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Universiteti “Fan Noli” Korçë si dhe Departamenti i Agroushqimit pranë këtij Universiteti bën të mundur sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Kjo me anë të miratimit dhe të Senatit Akademik.</p> <p>Në fillim të cdo semestri shpallet orari, dhe grupet për cdo kurs. Orari afshohet në ambjentet e Fakultetit të Bujqësisë dhe pedagogët kanë listat për prezencen e studentëve në auditor dhe praktika mësimore. Këto lista dorëzohen në fund të cdo semestri në sekretariatë mësimore. Shtojca 4.14, [Struktura e Vitit Akademik]. Shtojca 5.10.</p> <p>Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë përgatit periodikisht vlerësime të cilësisë me synime garantim të standarteve të cilësisë dhe është përgjegjës për politikën e vlerësimin dhe zbatimin e procedurave të sigurimit të brendshëm të cilësisë si dhe përgatit raportin për vlerësimin e jashtëm të cilësisë nga ekspertët e jashtëm të vlerësimin të cilësisë. Rezultatet e vlerësimin të brendshëm paraqiten me anë të një raporti i cili kryhet nga Njësia e Sigurimit të cilësisë në bazë të statutit të Universitetit neni 62. Shtojca 3.7, [Raporti Vjetor i NJSBC Fakulteti i Bujqësisë].</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Departamenti i Agroushqimit pranë Fakultetit të Bujqësisë përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. Në këtë Fakultet ka 9 Laboratorë të cilët shërbejnë për kryerjen e praktikave mësimore të fushës së Agroushqimit. Si dhe ka marrëveshje me Biznese të fushës së Agroushqimit për dërgimin e studentëve dhe</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p>furnizimin e tyre me informacion konkret të fushës së Përpunimit të Ushqimeve. Shtojca 4.14, [Struktura e Vitit Akademik], Njësia e sigurimit të brëndëshëm të cilësisë ngrihet nga titullari i Institucionit dhe organizon takime me staff akademik, ndihmës dhe student për mbledhjen e të gjithë të dhënave qe duhen për hartimin e raportit të sigurimit të cilësisë. Shtojca 3.7, [Raporti Vjetor i NJSBC Fakulteti i Bujqësisë]. Satffi akademik ka për detyrë ofrimin e të gjithë informacioneve për vlerësimin e brëndëshëm. Njësia e sigurimit të brëndëshëm të cilësisë përgatit raportin e vlerësimit të cilësisë së brëndëshme. Studentët angazhohen në anketimet dhe pyetsorët që bëhen në kuadër të sigurimit të cilësisë. Të gjithë këto komponentë ndikojne dhe kontrivojnë në sigurimin e cilësisë së brendshme të programit të studimit.</p>				
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohej përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit njësia bazë dhe kryesore është përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit. Kjo njësi bazë mbikqyr praktikën mësimore, praktikën kërkimore si dhe punën kërkimore të stafit të këtij Departamenti. Në bazë të notës mesatare, studentëve të ciklit të parë dhe të dytë i jepet mundësia e mbrojtjes së temës së Diplomës.</p>				
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Në proceset ciklike të vlerësimit është respektuar integriteti akademik dhe është shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm e vërteton këtë. Programi i studimit i është nënshtruar vlerësimeve të vazhdueshme, periodike dhe vlerësimeve dhe analizave vjetore për nxjerrjen e përfundimeve përkatëse. Bazuar në këto vlerësime ky program i është nënshtruar përmirësimeve të vazhdueshme. Kjo tregohet dhe në Analizat vjetore mësimore-kërkimore. Shtojca 3.8, [Analiza Vjetore e njësisë bazë Agroushqim].</p>				
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë janë bërë edhe bashkëpunëtorë dhe ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe i është nënshtruar përmirësimeve të vazhdueshme. Shtojca 4.14, [Struktura e Vitit Akademik]. Përmirësimet e vazhdueshme që bëhen në programin e studimit janë bazuar në vlerësime brënda dhe jashtë Institucionit. Krahasimi me programe të ngjashme brënda dhe jashtë ka ndikuar në përmirësimin e vazhdueshëm të tij. Projektet e bashkëpunimit me Universitetet jashtë dhe brënda vendit, dhe angazhimi stafit akademik me kohë të pjesëshme nga Universitete me programe të njëjta kanë ndikuar në përmirësimin vazhdueshëm të këtij program. Shtojca 3.7, [Raporti Vjetor i NJSBC Fakulteti i Bujqësisë]. Shtojca 4.12, [Lista e pjesëmarrjes së Stafit Akademik].</p>				
<p>Shkalla e përbushjes së</p>	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="560 1809 746 1879">Nuk përbushet</td> <td data-bbox="746 1809 954 1879">Përbushet pjesërisht</td> <td data-bbox="954 1809 1161 1879">Përbushet kryesisht</td> <td data-bbox="1161 1809 1364 1879">Përbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht		

standardit

X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve								
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Përditësimi i vazhdueshëm i informacioneve në faqen e Universitetit "Fan Noli" të Korçës tregon që veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. Nje pjese e rendesishme eshte edhe publikimi i raportit te vleresimit ne faqen Web, i cili pasqyron punen e gjithe strukturave te IAL (Shtojca 5.1)								
Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Sektori i Kurrikulave dhe i Sigurimit të cilësisë ka si detyrë Zhvillimin e programeve dhe Vlerësimin Institucional si dhe publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Shtojca 1.5, [Rregullore e Drejtorisë së Kurrikulave]. Shtojca 3.4, [Lista e NJSBC].								
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Pas vlerësimit të Bordit të Akreditimit Universiteti "Fan Noli" ka plotësuar rekomandimet e lëna dhe ka filluar punën për akreditimin e programeve të studimit. Shtojca 2.19, [Dokumente për akreditimin institucional]. Shtojca 1.18, [Plotësimi i rekomandimit për akreditimin institucional]. Shtojca 3.2, [Vendimi i rektoratit për akreditimin e programeve]. IAL angazhon te gjithe strukturat e saj ne permbushjen e ketyre sugjerimeve, te rendesishme per rivlersimin ne te ardhmen."								
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Në Universitetin e Korçës publikohen konkurset si dhe rezultatet e tyre; gjithashtu dhe rezultatet e provimeve. Ne këtë Institucion bëhet dhe një vlerësim i vazhdueshëm i pedagogëve me anë të pyetsorëve ndaj studentëve për performancën e tyre kjo në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. Shtojca 2.4, [Plani strategjik për zhvillimin e njësisë Agroushqim].								
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit, siç është takimi mbi Sondazhin Kombëtar të Studentëve e organizuar nga ASCAL. (Shtojca 5.11)								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI

Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

				X
--	--	--	--	---

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Agroushqim” të Institucionit të Arsimit të Lartë, Universiteti “Fan S. Noli” Korçë.

Pikat e forta dhe afirmime

1. Përmbajtja e programit të studimit me të gjitha lëndët bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore dhe ato plotësuese garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për fushën e përpunimit të ushqimeve dhe kontrollit të tyre.
2. Lëndët/modulet, shpërndarja e tyre në vite e semestra, mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe aftësimit profesional.
3. Pozicioni gjeografik i favorshëm në zhvillimin e projekteve kërkimore shkencore, i cili ndihmon në aftësimin dhe angazhimin maksimal të personelit në procesin mësimor dhe akademik.
4. Stafit akademik me kualifikimin e duhur të fushës akademike dhe kërkimore shkencore është i angazhuar me publikimet në përputhje me programin e studimit dhe specifikën e moduleve të këtij programi.
5. Mjedise dhe Infrastrukturë bashkëkohore për një zhvillim normal të punës mësimore dhe kërkimore-shkencore pranë Departamentit “Agroushqim
6. Kryerja e studimeve eksperimentale nga ana e studentëve në ambientet e laboratorëve shkencorë që disponon Departamenti ndihmon në njohjen teorike dhe praktike në Industrinë Ushqimore.
7. Organizimi i mirë i Praktikave profesionale në fushat e bujqësisë dhe agropërpunimit, i jep mundësi studentëve të përfitojnë eksperiencë praktike, për ti shfrytëzuar në Industrinë e përpunimit Agroushqimor.
8. Organizimi i sistemit elektronik të Zyrës së Sekretarisë Mësimore, i jep mundësi studentëve të informohen dhe komunikojnë me personelin akademik të Departamentit.

Pika të dobëta

1. Promovimi i Programit të Studimit të ciklit të parë Bachelor “Agroushqim”, ndaj maturantëve në gjimnaze dhe shkolla profesionale.
2. Numri i pedagogëve të jashtëm më i madh se numri i pedagogëve të brendshëm. Prandaj lind nevoja e rekrutimit të stafit të ri pedagogjik të brendshëm.
3. Institucionalizimi jo i plotë me përfitim dypalësh i marrëdhënieve me universitete brenda dhe jashtë vendit, me operatorët e biznesit, në drejtim të përfshirjes më të madhe të studentëve në kërkimin shkencor për zgjidhjen e problematikave të ndryshme që kanë lidhje me Industrinë e Përpunimit Agroushqimor.
4. Pjesëmarrje e kufizuar në projekte kërkimore shkencore nga anëtarët e Departamentit për të pajisur Departamentin me pajisje laboratorike në funksion të programit të studimit.

Rekomandime

1. Përmirësimi i programit të promovimit me zyrat përkatëse, duke patur parasysh numrin jo të kënaqshëm të studentëve që duan të frekuentojnë këtë program studimi.



2. Përmirësimi i planit mësimor Bachelor "Agroushqim" në përputhje me sugjerimet në fushat përkatëse të RVJ, duke pasur parasysh tendencat në rritje e kërkesave të tregut të punës në sektorin e industrisë agroushqimore.
3. Përmirësimi dhe standardizimi i syllabusave në lidhje me planet mësimore dhe plotësimi i tyre me literaturë të re dhe bashkëkohore të viteve të fundit.
4. Nevoja për zgjerim, pajisje dhe modernizim të ambienteve të mësimdhënies, duke pasur parasysh numrin e studentëve.
5. Të rriten mundësitë financiare dhe të shtohet buxheti për pajisje laboratorike/praktikat mësimore në funksion të rritjes së cilësisë të programit të studimit.
6. Rritje të bashkëpunimit të departamentit me institucione të arsimit të lartë në vend dhe jashtë tij, duke përmirësuar veprimtarinë e tij.
7. Rritje të bashkëpunimit të Departamentit me operatorët e bizneseve për të rritur numrin e pjesmarrjes së studentëve në kërkimin shkencor për zgjidhjen e problematikave të ndryshme që kanë lidhje me Industrinë Ushqimore.


Conclusions of the Evaluation of the first cycle study program Bachelor "Agro Nutrition" of Higher Education Institution the University "Fan S. Noli" Korça.

Strengths and affirmations

1. The content of the study program with all basic, characteristic, interdisciplinary and supplementary subjects guarantees the acquisition of knowledge, skills and competencies intended for the field of food processing and their control.
2. The subjects / modules, their distribution in years and semesters, enable the achievement of the formation objectives of the study and the professional training program.
3. Favorable geographical position in the development of scientific research projects, which helps in the training and maximum engagement of staff in the teaching and academic process.
4. The academic staff with the appropriate qualification of the academic field and scientific research is engaged with publications in accordance with the study program and the specifics of the modules of this program.
5. Contemporary environments and infrastructure for a normal development of teaching and research work at the Department "Agro-Nutrition".
6. Conducting experimental studies by students in the premises of scientific laboratories available to the Department helps in theoretical and practical knowledge in the Food Industry.
7. Good organization of professional internships in the fields of agriculture and agro-processing, gives students the opportunity to gain practical experience, to be used in the agri-food processing industries.
8. The organization of the electronic system of the Office of the Teaching Secretary, enables students to be informed and communicate with the academic staff of the Department

Weak points


1. Promotion of the Study Program of Bachelor "Agro-Nutrition", to graduates in high schools and professional schools.

2. The number of external lecturers is greater than the number of internal lecturers. Therefore, there is a need to recruit new internal pedagogical staff.
3. Incomplete institutionalization with mutual benefit of relations with universities inside and outside the country, with business operators, in terms of greater involvement of students in scientific research to solve various problems related to the Agro-Nutrition Processing Industry.
4. Limited participation in scientific research projects by members of the Department, to equip the Department with laboratory equipment in function of the study program.

Recommendations

1. Improving the promotion program with the relevant offices, given the unsatisfactory number of students who want to attend this study program.
2. The need to recruit new internal pedagogical staff with titles and related to the field.
3. Improving the Bachelor curriculum "Agro-Nutrition" in accordance with the suggestions in the relevant areas, given the growing trends of labor market demands in the agro-nutrition industry sector.
4. Improving and standardizing the syllabus in relation to the curricula and supplementing them with new and contemporary literature of recent years.
5. The need for expansion, equipment and modernization of teaching facilities, according to the number of students.
6. To increase the financial possibilities and the budget for laboratory equipment / teaching practices in order to increase the quality of the study program.
7. Increasing the cooperation of the department with higher education institutions in the country and abroad, improving its activity.
8. Increase the cooperation of the Department with business operators to increase the number of students participating in scientific research to solve various problems related to the Food Industry.



Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushet	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X